



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË OPERACIONALE TË SHOQËRIVE
KOMISIONERE DHE BANKAVE QË OFROJNË SHËRBIME INVESTIMI**

Miratuar me Vendim Bordi nr. 16, datë 28.02.2023

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi i Rregullores**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe ushtrimit të veprimtarisë operationale të subjekteve që ofrojnë shërbime dhe veprimtari investimi, kërkesa të cilat synojnë në mbrojtjen e interesave të klientëve, në sigurimin e funksionimit të drejtë e të rregullt të tregjeve të kapitalit, dhe në rritjen e standardeve profesionale të këtyre subjekteve.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore është hartuar në mbështetje dhe zbatim të nenit 48, paragrafi 2, nenit 50, paragrafi 1 dhe 2, nenit 55, paragrafi 5, nenit 68, paragrafi 20, nenit 69, paragrafi 3 dhe 4 dhe nenit 115, paragrafi 8 të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për tregjet e kapitalit”, të referuara këtu si “Ligji”.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet nga shoqëritë komisionere të licencuara, të regjistruara dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, si dhe nga bankat që ofrojnë shërbime investimi.
2. Kudo në këtë Rregullore, shoqëria komisionere do të nënkuptojë edhe bankën që ofron shërbime investimi.
3. Pavarësisht, paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni, nenet e kësaj rregulloreje nuk ndikojnë në strukturën organizative të bankave dhe shoqërive komisionere të regjistruara dhe të njohura.
4. Në rastin e bankës që ofron shërbime investimi linjat e raportimit të strukturave përkatëse janë në varësi të organizimit të bankës.

Neni 4

Përkufizime

Të gjitha përkufizimet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim si ato në Ligj.

Neni 5

Ofrimi i shërbimit të investimit në mënyrë të rastësishme

1. Për qëllim të përjashtimit të parashikuar në nenin 10, pika (c) të Ligjit, shërbimi i investimit do të konsiderohet se është ofruar në mënyrë të rastësishme gjatë kryerjes së një veprimtarie profesionale, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - (a) ekziston një lidhje e ngushtë dhe faktike midis veprimtarisë profesionale dhe ofrimit të shërbimit të investimit për të njëjtin klient, me kusht që shërbimi i investimit të jetë ndihmës për veprimtarinë kryesore profesionale;
 - (b) ofrimi i shërbimeve të investimit për klientët e veprimtarisë kryesore profesionale nuk synon të ofrojë një burim sistematik të ardhurash për personin që kryen veprimtarinë profesionale; dhe
 - (c) personi që ofron aktivitetin profesional nuk reklamon apo promovon aftësinë e tij për të ofruar shërbime investimi, me përjashtim të rasteve kur këto u paraqiten klientëve si ndihmëse për aktivitetin kryesor profesional.

KREU II
KËRKESAT ORGANIZATIVE DHE RREGULLAT E SJELLJES

Seksioni 1
Organizimi

Neni 6
Kërkesat organizative

1. Shoqëria komisionere duhet të ketë politika dhe procedura të përshtatshme për të siguruar përputhshmërinë e shoqërisë, përfshirë drejtuesit, punonjësit dhe agjentët e lidhur, me kërkesat e Ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria komisionere duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar vazhdimësi dhe rregullsi në kryerjen e shërbimeve dhe veprimtarive të investimit. Për këtë qëllim, shoqëria komisionere përdor sisteme, burime dhe procedura të përshtatshme në proporcion me natyrën, madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj.
3. Shoqëria komisionere duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme organizative:
 - (a) të hartojë, zbatojë dhe ruajë procedurat e vendimmarrjes dhe një strukturë organizative, e cila në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar përcakton linjat e raportimit dhe shpërndan funksionet dhe përgjegjësitë;
 - (b) të sigurojë se personat përkatës të shoqërisë janë në dijeni të procedurave që duhet të ndiqen për përmbushjen e duhur të përgjegjësisë së tyre;
 - (c) të krijojë, zbatojë dhe ruajë mekanizmat e duhur të kontrollit të brendshëm, të hartuara për të siguruar përputhjen me vendimet dhe procedurat në të gjitha nivelet e shoqërisë komisionere;
 - (d) të punësojë personel me aftësitë, njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për zbatimin e përgjegjësisë që u janë caktuar;
 - (e) të ketë, zbatojë dhe dokumentojë linja efikase të raportimit të brendshëm dhe të komunikimit të informacionit në të gjitha nivelet përkatëse të shoqërisë komisionere;
 - (f) të mbajë rregullisht të dhëna mbi veprimtarinë dhe organizimin e brendshëm të tyre;
 - (g) të sigurojë se kryerja e më shumë se një funksioni nga personat përkatës të shoqërisë nuk i pengon atë të kryejë çfarëdo funksioni të caktuar në mënyrë të plotë, të ndershme dhe profesionale.

Në zbatimin e kërkesave të përcaktuara në shkronjat nga (a) në (g) të këtij paragrafi, shoqëria komisionere merr parasysh natyrën, madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së shoqërisë, si dhe natyrën dhe gamën e shërbimeve dhe veprimtarive të investimit të ndërmarra.

4. Shoqëria komisionere duhet të ketë mekanizma të qëndrueshëm sigurie për të garantuar sigurinë dhe vërtetësinë e mjeteve të transferimit të informacionit, për të minimizuar rrezikun e dëmtimit të të dhënave dhe aksesin e paautorizuar dhe për të parandaluar rrjedhjen e informacionit duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave gjatë gjithë kohës.

5. Shoqëria komisionere duhet të krijojë, zbatojë dhe zhvillojë një politikë të duhur për vazhdimësinë e veprimtarisë tregtare, e cila synon të sigurojë, në rast të një ndërprerjeje të sistemeve dhe procedurave të tyre, ruajtjen e të dhënave dhe funksioneve thelbësore, si dhe mirëmbajtjen e shërbimeve dhe veprimtarive të investimit, ose, kur kjo nuk është e mundur, rikuperimin në kohë të këtyre të dhënave dhe funksioneve dhe rifillimin në kohë të shërbimeve dhe veprimtarive të investimit.
6. Shoqëria komisionere duhet të hartojë, zbatojë dhe dokumentojë politika dhe procedura kontabël që i mundësojnë asaj dorëzimin në kohë të raporteve financiare tek Autoriteti, raporte të cilat japin një panoramë të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar në përputhje me standardet dhe rregullat e kontabilitetit në fuqi.
7. Shoqëria komisionere duhet të ketë mekanizma të kontrollit të brendshëm, procedura efikase për menaxhimin e rrezikut si dhe rregulla për mbrojtjen e sistemeve të përpunimit të informacionit. Shoqëria komisionere monitoron, dhe vlerëson rregullisht përshtatshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve të saj, mekanizmave të kontrollit të brendshëm si dhe të aspekteteve të tjera organizative të parashikuara në paragrafët (3) deri në (6) të këtij neni dhe merr masat e duhura për të adresuar çdo mangësi.

Seksioni 2

Funksioni i përputhshmërisë

Neni 7

Politikat dhe procedurat në lidhje me përputhshmërinë

1. Shoqëritë komisionere duhet të hartojnë, zbatojnë dhe mbajnë gjatë gjithë kohës politika dhe procedura të përshtatshme për zbulimin dhe minimizimin e rrezikut të mospërbushjes së detyrimeve/kërkesave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi, si dhe rreziqeve të lidhura me to, si dhe të kenë në zbatim masa dhe procedura të mjaftueshme për të minimizuar rreziqe të tilla dhe që t'i mundësojnë Autoritetit ushtrimin e kompetencave në mënyrë efikase.
2. Shoqëritë komisionere, në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave marrin në konsideratë natyrën, madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë tregtare, si dhe natyrën dhe gamën e shërbimeve dhe veprimtarive të investimit të ndërmarra.
3. Shoqëritë komisionere krijojnë dhe mbajnë një funksion të përhershëm dhe efikas përputhshmërie, i cili vepron në mënyrë të pavarur dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:
 - (a) të monitorojë në mënyrë të përhershme dhe të vlerësojë, rregullisht, përshtatshmërinë dhe efikasitetin e masave, politikave dhe procedurave që zbatohen në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, si dhe veprimet e ndërmarra për të adresuar çfarëdo mangësie në përmbushjen e detyrimeve nga ana e shoqërisë;
 - (b) të këshillojë dhe të ndihmojë personat përkatës përgjegjës për kryerjen e shërbimeve dhe veprimtarive të investimit për të përmbushur detyrimet e shoqërisë sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje;
 - (c) t'i raportojë organit drejtues, të paktën një herë në vit, mbi zbatimin dhe efikasitetin e mjedisit të përgjithshëm të kontrollit për shërbimet dhe veprimtaritë e investimit, mbi

rreziqet që janë identifikuar dhe për raportimin e trajtimit të ankesave, si dhe masat e ndërmarra apo që do të ndërmerren;

- (d) të monitorojë veprimet lidhur me procesin e trajtimit të ankesave dhe t'i konsiderojë ankesat si një burim i domosdoshëm informacioni në kuadër të përgjegjësisë të përgjithshme monitoruese.

Funksioni i përputhshmërisë kryen një vlerësim, në bazë të të cilit do të krijojë një program monitorimi që bazohet në risk, i cili merr në konsideratë të gjitha fushat e shërbimeve të investimit të shoqërisë komisionere, veprimtarive dhe çdo shërbim ndihmës përkatës, duke përfshirë informacionet përkatëse të mbledhura në lidhje me monitorimin e trajtimit të ankesave. Programi i monitorimit përcakton prioritetet e vendosura nga vlerësimi i rrezikut të përputhshmërisë duke siguruar që rreziku i përputhshmërisë të monitorohet në mënyrë gjithëpërfshirëse.

4. Për t'i mundësuar funksionit të përputhshmërisë të referuar në paragrafin (3) të këtij neni të kryejë përgjegjësitë e veta në mënyrën e duhur dhe të pavarur, shoqëritë komisionere duhet të sigurojnë plotësimin e kushteve të mëposhtme:
- (a) funksioni i përputhshmërisë ka kompetencat, burimet, ekspertizën dhe aksesin e nevojshëm në të gjitha informacione përkatëse;
 - (b) njësia që kryen funksionin e përputhshmërisë i raporton në mënyrë "ad-hoc" drejtpërdrejt organit drejtues kur zbulon një rrezik të konsiderueshëm të mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e shoqërisë sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje;
 - (c) personat përkatës të përfshirë në funksionin e përputhshmërisë nuk janë të përfshirë në kryerjen e shërbimeve ose aktiviteteve që ata monitorojnë;
 - (d) metoda e përcaktimit të shpërblimit të personave përkatës që kryejnë funksionin e përputhshmërisë nuk cënon objektivitetin e tyre dhe nuk priret ta bëjë këtë.
5. Pikat (c) dhe (d) të paragrafit (4) të këtij neni, nuk gjejnë zbatim kur shoqëria komisionere vërteton se kriteret e përcaktuara në pikat (c) dhe (d) të paragrafit (4) të këtij neni nuk janë në përputhje me natyrën, madhësinë dhe kompleksitetin e biznesit të saj, si dhe natyrën dhe gamën e shërbimeve dhe veprimtarive të investimit, dhe se në çdo rast funksioni i përputhshmërisë së saj vazhdon të jetë efikas. Në këtë rast, shoqëria komisionere vlerëson nëse efikasiteti i funksionit të përputhshmërisë është i rrezikuar. Ky vlerësim rishikohet rregullisht, të paktën një herë në vit.

Seksioni 3

Funksioni i Administrimit të rrezikut

Neni 8

Politikat dhe procedurat në lidhje me administrimin e rrezikut

1. Shoqëria komisionere duhet të ketë një sistem të administrimit të rrezikut të përshtatshëm për veprimtarinë që ushtron.
2. Ky sistem ka për qëllim të sigurojë identifikimin, kontrollin dhe zbutjen e të gjitha rreziqeve tregtare dhe operative. Në këto rreziqe përfshihen:

- (a) moszbatimi i Ligjit dhe i bazës rregullatore të dalë në zbatim të Ligjit;
- (b) mosidentifikimi dhe mosmbajtja në kontroll e konfliktit të interesit;
- (c) mosmbajtja në kontroll e zbatimit të marrëveshjeve kontraktore me klientët;
- (d) moskategorizimi i klientëve si palë të pranueshme, klientë profesionistë, klientë të kualifikuar ose klientë joprofesionistë;
- (e) moszbatimi i procedurave të duhura për secilën kategori të klientëve;
- (f) zbatimi i çmimeve të gabuara ose i çmimeve jo më të mira në transaksione;
- (g) mostrajtimi me ndershmëri i klientëve dhe i investitorëve;
- (h) shkaktimi i humbjeve klientëve si pasojë e mosfunksionimit administrativ;
- (i) mungesa e komunikimit me furnitorët e shërbimeve dhe mosmbajtja e tyre nën kontroll;
- (j) mosmbajtja nën kontroll e pikave të shitjeve dhe agjentëve të lidhur;
- (k) humbja e besimit të klientëve si pasojë e reklamave mashtruese;
- (l) humbje biznesi si pasojë e rezultateve të këqija dhe shërbimit të dobët.

3. Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë komisionere është përgjegjës për të siguruar që:

- (a) është krijuar dhe zbatohet një sistem i pavarur i administrimit të rrezikut;
- (b) merr raporte të rregullta për procesin e administrimit të rrezikut;
- (c) informohet për çdo risk madhor në momentin kur ai lind dhe identifikohet;
- (d) identifikohen dhe analizohen në mënyrë sasiore të gjitha rreziqet;
- (e) hartohet dhe kuptohet kuadri i administrimit të rrezikut;
- (f) sistemi i administrimit të rrezikut mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme;
- (g) bëhen shqyrtime dhe testime të rregullta të kuadrit të administrimit të rrezikut.

4. Njësia e administrimit të rrezikut është e pavarur dhe raporton drejtpërdrejtë te Këshilli i Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës ose administratori/ët.

5. Njësia e Administrimit të Rrezikut ka këto përgjegjësi:

- (a) monitoron dhe vlerëson rreziqet në përputhje me procedurën e miratuar;
- (b) i vendos manuale në dispozicion secilit departament;
- (c) bën trajnimin e brendshëm të personelit për administrimin dhe identifikimin e rreziqeve;
- (d) harton dhe i paraqet Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës raporte të rregullta për administrimin e rrezikut;
- (e) sugjeron ndryshime në procesin e administrimit të rrezikut, bazuar në përvojat aktuale;
- (f) identifikon rreziqet e reja, që lindin si pasojë e ndryshimeve në mjedisin tregtar, në modelin tregtar ose nga produktet e reja.

6. Shoqëria komisionere ndërmerr veprimet e mëposhtme në lidhje me administrimin e rrezikut:

- (a) krijon, zbaton dhe mban gjatë gjithë kohës politika dhe procedura të përshtatshme për administrimin e rrezikut, të cilat identifikojnë rreziqet që lidhen me aktivitetet, proceset dhe sistemet e shoqërisë, si dhe nëse është e përshtatshme, caktojnë nivelin e rrezikut të toleruar nga shoqëria;

- (b) miraton procese dhe mekanizma efikase për të administruar rreziqet që lidhen me aktivitetet, proceset dhe sistemet e shoqërisë, në kuadër të atij niveli tolerance ndaj riskut;
- (c) monitoron sa vijon:
 - (i) përshtatshmërinë dhe efikasitetin e politikave dhe procedurave për administrimin e rrezikut të shoqërisë komisionere;
 - (ii) nivelin e përputhshmërisë nga shoqëria komisionere dhe personat e saj përkatës me proceset dhe mekanizmat e miratuar në përputhje me shkronjën (b) të këtij paragrafi;
 - (iii) përshtatshmërinë dhe efikasitetin e masave të marra për të adresuar çdo mangësi në to, politika, procedura, rregulla, procese dhe mekanizma, duke përfshirë mosrespektimin nga personat përkatës të këtyre masave, proceseve dhe mekanizmave ose ndjekjen e këtyre politikave dhe procedurave.

7. Shoqëria komisionere krijon dhe mban funksionin/sistemin për administrimin e rrezikut, i cili operon në mënyrë të pavarur dhe zbaton politikën dhe procedurat e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni.

Seksioni 4 **Auditimi i brendshëm**

Neni 9 **Funksioni i auditimit të brendshëm**

1. Shoqëria komisionere duhet të ketë një sistem të auditimit të brendshëm të përshtatshëm për veprimtarinë që ushtron.
2. Njësia përgjegjëse për kryerjen e funksionit të auditimit të brendshëm është e ndarë dhe e pavarur nga funksionet dhe aktivitetet e tjera të shoqërisë. Kjo njësi harton, zbaton dhe dokumenton një plan auditimi për të ekzaminuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve, mekanizmave të kontrollit të brendshëm të shoqërisë komisionere dhe nxjerr rekomandime bazuar në rezultatin e punës së kryer si dhe verifikon përputhshmërinë me këto rekomandime;
3. Njësia e Auditimit të Brendshëm i raporton drejtpërdrejt Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës si më poshtë:
 - (a) nëse shoqëria komisionere është e organizuar në mënyrë të tillë që të nxisë administrimin efektiv dhe të kujdesshëm të veprimtarisë tregtare, si dhe i jep informacion Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës për çështje organizative dhe kontabël;
 - (b) që të gjithë punonjësit janë të trajnuar siç duhet, i kuptojnë funksionet dhe përgjegjësitë dhe pajisen me manuale për procedurat;
 - (c) që i gjithë personeli operativ i respekton rregullat dhe procedurat, që kanë të bëjnë me pozicionet e tyre të veçanta;
 - (d) për identifikimin e pikave të dobëta të sistemeve dhe masave kontrolluese, që mund të çojnë në humbje ose në mospërputhshmëri;

- (e) për zbatimin e parimeve të drejtimit të brendshëm të shoqërisë, përcakton politikat dhe strategjitë për respektimin e këtyre parimeve, si dhe vlerëson çdo vit zbatimin e këtyre politikave e strategjive;
- (f) për mjaftueshmërinë e kontrollit financiar dhe respektimin e kufizimeve të miratuara të përgjegjësisë për kryerjen e shpenzimeve;
- (g) për identifikimin dhe hetimin e rasteve të mundshme të vjedhjes, të mashtrimit ose të shkeljeve nga ana e personelit;
- (h) për përmirësimin ose rishikimin e objektivave, strategjisë, planeve të biznesit dhe politikave kryesore, që rregullojnë veprimtarinë e institucionit;
- (i) për të mundësuar shqyrtimin e objektivave, të strategjisë dhe të politikave të biznesit, si dhe të kontrollojë zbatimin e tyre nga funksionarët kryesorë;
- (j) për të siguruar që sistemi i kontabilitetit të shoqërisë komisionere ofron informacione të sakta dhe në kohën e duhur lidhur me kapitalin e vet, burimet financiare, mjaftueshmërinë e kapitalit dhe rentabilitetin.

4. Shoqëria komisionere krijon Komitetin e Auditimit në përputhje me kërkesat e nenit 115 të Ligjit.

Neni 10

Kritere të veçanta për auditimin e brendshëm

1. Veprimtaritë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm mbulojnë të gjitha veprimtaritë dhe proceset e shoqërisë komisionere bazuar në një qasje të orientuar drejt rrezikut.
2. Auditimi i Brendshëm mund të përfshihet në projekte kryesore por duke ruajtur në çdo kohë pavarësinë e tij dhe shmangur konfliktet e interesit.
3. Njësia e Auditimit të Brendshëm kryen detyrat e saj në mënyrë autonome dhe të pavarur. Në veçanti, Komiteti i Auditimit të Brendshëm duhet të sigurojë që nuk i nënshtrohet asnjë udhëzimi në lidhje me veprimtaritë e tij të raportimit dhe vlerësimit. E drejta e drejtuesve të lartë të shoqërisë për të urdhëruar auditime shtesë nuk duhet të bjerë ndesh me autonominë dhe pavarësinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.
4. Stafit i që kryen auditimin e brendshëm të shoqërisë nuk mund të kryejë detyra që nuk kanë të bëjnë me funksionin e auditimit të brendshëm. Njësia e Auditimit të Brendshëm mund të ofrojë këshillia apo rekomandime për drejtuesit e lartë ose njësitë e tjera organizative të shoqërisë komisionere brenda fushës së detyrave të saj, por me kusht që të ruajë pavarësinë e saj.
5. Anëtarëve të stafit, të punësuar në njësitë e tjera organizative të shoqërisë komisionere nuk mund t'u besohen detyra të Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Megjithatë, kjo nuk përjashton situatat e justifikuara në të cilat punonjësit e tjerë, për shkak të ekspertizës së tyre të veçantë, mund të kryejnë veprimtari për auditimin e brendshëm në mënyrë të përkohshme.
6. Veprimtaritë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm bazohen në një plan auditimi gjithëpërfshirës, i cili përditësohet çdo vit. Planifikimi i auditimit duhet të jetë i orientuar drejt riskut. Veprimtaritë dhe proceset e shoqërisë komisionere, edhe nëse janë të

deleguar tek persona të tretë, do të auditohen në intervale të përshtatshme, të paktën çdo tre vjet. Auditimi kryhet çdo vit nëse ekzistojnë rreziqe të veçanta.

7. Planifikimi i auditimit, metodat dhe cilësia e auditimit duhet të rishikohen dhe zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme.
8. Duhet të sigurohet që çdo auditim i posaçëm që kërkohet për t'u realizuar shumë shpejt, p.sh. për shkak të mangësive që kanë lindur ose kritereve të caktuara informative, mund të kryhet në çdo kohë.
9. Planifikimi i auditimit, si dhe çdo ndryshim i rëndësishëm i tij, duhet të miratohet nga Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës.
10. Funkzioni apo Njësia e Auditimit të Brendshëm përgatit një raport me shkrim për çdo auditim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe ia dorëzon këtë raport Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës. Raporti duhet të përfshijë në veçanti një përshkrim të subjektit të auditimit dhe gjetjeve, duke përfshirë çdo masë të planifikuar aty ku është e përshtatshme. Çdo gjetje madhore duhet të evidentohet qartë dhe rezultatet e auditimit duhet të vlerësohen. Në rast të konstatimeve të rënda, raporti i dorëzohet menjëherë Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës.
11. Çdo auditim i Njesisë së Auditimit të Brendshëm duhet të dokumentohet duke treguar punën e kryer, gjetjet, konkluzionet dhe masat korrigjuese që duhen marrë. Raporti me shkrim i auditimit hartohet në mënyrë transparente dhe të kuptueshme për palët e treta.
12. Nëse nuk mund të arrihet një konsensus ndërmjet Njesisë Organizative të Audituar dhe Njesisë së Auditimit të Brendshëm në lidhje me zbatimin e masave korrigjuese, Njësia Organizative e audituar duhet të shprehet përmes një deklarate që duhet të përfshihet në raportin e auditimit.
13. Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të përgatisë një raport të përgjithshëm për të gjitha auditimet e kryera gjatë vitit financiar dhe t'ia dorëzojë Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës sa më shpejt që të jetë e mundur. Raporti i përgjithshëm duhet të ofrojë informacione mbi gjetjet kryesore dhe masat korrigjuese të marra. Ai duhet të përmbajë edhe informacion nëse dhe në çfarë mase e ka realizuar planin e auditimit Njësia e Auditimit të Brendshëm, dhe e ka respektuar apo jo planin e auditimit.
14. Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës duhet të informohet menjëherë në rast se auditimi identifikon gjetje të rënda për cilido anëtar të Këshillit. Më pas, Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës informon menjëherë Autoritetin.
15. Raportet e auditimit dhe dokumentacioni mbështetës duhet të ruhen për periudhën kohore të kërkuar nga legjislacioni në fuqi.
16. Funkzioni i Auditimit të Brendshëm duhet të kryejë vlerësimet e duhura për të siguruar që çdo gjetje e identifikuar gjatë auditimit të brendshëm të korrigjohet brenda periudhës së kërkuar dhe të rënë dakord. Aty ku është e përshtatshme, ai kryen një auditim tjetër.
17. Nëse gjetjet e rënda nuk korrigjohen brenda një periudhe të përshtatshme kohore, drejtuesi i Auditimit të Brendshëm informon me shkrim Këshillin e

Administrimit/Këshillin Mbikëqyrës. Nëse gjetjet mbeten të pazgjidhura, Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës informohen sërish për këto gjetje me shkrim në raportin e përgjithshëm të ardhshëm.

Seksioni 5

Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës

Neni 11

Përgjegjësia e Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës

1. Shoqëritë komisionere, gjatë ndarjes së funksioneve brenda shoqërisë, duhet të sigurojnë që Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës, të jenë përgjegjës për të siguruar që shoqëria të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj rregulloreje. Në mënyrë të veçantë, Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës duhet të vlerësojë dhe rishikojë periodikisht efikasitetin e politikave, sistemeve dhe procedurave të përcaktuara për të përmbushur detyrimet sipas kësaj rregulloreje dhe të marrë masat e duhura për të adresuar çdo mangësi.
2. Ndarja e funksioneve të rëndësishme ndërmjet anëtarëve të Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës do të përcaktojë qartë se kush është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe ruajtjen e kritereve organizative të shoqërisë. Regjistrimet e ndarjes së funksioneve të rëndësishme duhet të mbahen të përditësuara.
3. Shoqëritë komisionere sigurojnë që Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës ka marrë, të paktën një herë në vit, raporte të shkruara për çështje që mbulohen nga Seksioni (2) deri në (4) i Kreut II të kësaj rregulloreje, në mënyrë të veçantë nëse janë marrë masat e duhura korrigjuese në rast të ndonjë mangësie.

Seksioni 6

Trajtimi i ankesave dhe sinjalizimi

Neni 12

Trajtimi i ankesave

1. Shoqëria komisionere duhet të ketë një njësi përgjegjëse për kryerjen e funksionit të trajtimit të ankesave.
2. Shoqëria komisionere duhet të hartojë, miratojë dhe të zbatojë procedura për trajtimin dhe zgjidhjen në kohë të çdo mosmarrëveshjeje dhe ankese të bërë nga klientët ekzistues apo të mundshëm të saj.
3. Procedura e parashikuar në paragrafin (1) të këtij neni miratohet nga Këshilli i Administrimit/ Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë.
4. Procedura e trajtimit të ankesave duhet të përmbajë informacione të qarta, të sakta dhe të përditësuara në lidhje me procesin e trajtimit të ankesave dhe duhet të përfshijë minimalisht:
(a) procesin dhe mënyrën e depozitimit të një ankese pranë shoqërisë komisionere;

- (b) deklarin se depozitimi i një ankese dhe procesi i trajtimit të saj është pa pagesë;
 - (c) mënyrën dhe formën e konfirmimit se shoqëria komisionere e ka marrë ankesën e bërë nga klienti;
 - (ç) afatin kohor, brenda të cilit do të trajtohet ankesa nga ana e shoqërisë komisionere;
 - (d) parashikime që ankesat do të trajtohen në mënyrë të menjëhershme, të barabartë, të drejtë dhe me efikasitet,
 - (dh) parashikime se të dhënat dhe informacionet personale brenda një ankese u nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave si dhe rregullave të brendshme të shoqërisë komisionere.
5. Çdo klienti duhet t'i vendoset në dispozicion një shpjegim i të drejtave që ka dhe i procedurës që mund të ndjekë për t'u ankuar ndaj shoqërisë komisionere.
 6. Gjatë trajtimit të një ankese, shoqëria komisionere komunikon me klientët eksistues ose klientët e mundshëm në mënyrë të qartë, në një gjuhë të thjeshtë që është e lehtë për t'u kuptuar duke shmangur vonesat e panevojshme.
 7. Shoqëritë komisionere u komunikojnë qëndrimin e tyre, lidhur me ankesën, klientëve ose klientëve të mundshëm dhe i informojnë klientët ose klientët e mundshëm për zgjidhjet e tyre.
 8. Shoqëritë komisionere krijojnë dhe mbajnë regjistrin e ankesave ku mbahet evidencë për ankesat e marra, çdo komunikim dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre.
 9. Shoqëritë komisionere i japin Autoritetit, me kërkesë të tij, informacione për ankesat dhe trajtimin e tyre, sipas këtij neni.
 10. Funkzioni i përputhshmërisë i shoqërive komisionere analizon të dhënat për ankesat dhe mënyrën e trajtimit të tyre për të siguruar se ato identifikojnë dhe adresojnë siç duhet çdo rrezik apo problem.

Neni 13 Sinjalizimi

Shoqëria komisionere harton politika apo procedura të brendshme në përputhje me legjislacionin në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit.

Seksioni 7 Shpërblimet

Neni 14 Politikat dhe praktikat e shpërblimeve

1. Shoqëritë komisionere përcaktojnë dhe zbatojnë politika dhe praktikat e shpërblimeve sipas procedurave të brendshme përkatëse duke marrë parasysh në konsideratë interesat e të gjithë klientëve të shoqërisë, me qëllim që të sigurohet se klientët trajtohen në mënyrë

të drejtë dhe të mos cenohen interesat e tyre nga praktikat e shpërblimit të miratuara nga shoqëria komisionere në afat të shkurtër, të mesëm, ose të gjatë.

Politikat dhe praktikat e shpërblimit duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të mos krijojnë një konflikt interesi ose stimuj që mund t'i shtyjë personat përkatës të favorizojnë interesat e tyre ose interesat e shoqërisë në dëm të mundshëm të çfarëdo klienti.

2. Shoqëritë komisionere do të përcaktojnë dhe zbatojnë politikat dhe praktikat e shpërblimit sipas procedurave të brendshme përkatëse duke marrë parasysh interesat e të gjithë klientëve të shoqërisë, me qëllim që të sigurohet se klientët trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të mos cenohen interesat e tyre nga praktikat e pagesës të miratuara nga shoqëria komisionere në afat të shkurtër, të mesëm, ose të gjatë.
3. Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë komisionere do të miratojë, pas marrjes së këshillimit nga funksioni i përputhshmërisë, politikën e shpërblimeve të shoqërisë për punonjësit. Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës, nëse është e aplikueshme, do të miratojë politikën e shpërblimeve të anëtarëve të Këshillit. Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë komisionere do të jetë përgjegjës për zbatimin e politikës së shpërblimeve dhe monitorimin e risqeve të përputhshmërisë që lidhen me politikën.
4. PAGESA dhe stimujt e ngjashëm bazohen në kritere sasiore tregtare dhe kritere cilësore që pasqyrojnë pajtueshmërinë me rregulloret në fuqi, trajtimin e drejtë të klientëve dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për klientët.
5. Në çdo kohë duhet të ruhet një ekuilibër ndërmjet komponentëve fiks dhe të ndryshueshëm të pagesës, në mënyrë që struktura e pagesës të mos favorizojë interesat e shoqërisë komisionere ose të personave të saj përkatës kundrejt interesave të cilido klienti.

Seksioni 8 Transaksionet personale

Neni 15 Objekti i transaksioneve personale

1. Shoqëria komisionere vendos rregulla të përshtatshme lidhur me transaksionet personale nga anëtarët e Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës, punonjësit dhe agjentët e lidhur.
2. Për qëllim të nenit 16 (1) të kësaj rregulloreje, transaksioni personal është tregtimi i një instrumenti financiar që kryhet nga ose në emër të një personi përkatës, kur plotësohet të paktën një nga kriteret e mëposhtme:
 - (a) personi përkatës vepron jashtë objektit të veprimtarive që ai kryen në cilësinë e tij profesionale;
 - (b) Tregtimi kryhet për llogari të kujtdo prej personave të mëposhtëm:
 - (i) personit përkatës;

- (ii) kujtdo personi me të cilin ka lidhje familjare, ose me të cilin ka lidhje të ngushta;
- (iii) një personi në lidhje me të cilin personi përkatës ka një interes material të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në rezultatin e tregtimit, përveç marrjes së një tarife ose komisioni për realizimin e transaksionit.

Neni 16

Transaksione personale

1. Shoqëritë komisionere hartojnë, zbatojnë dhe dokumentojnë procedura që synojnë parandalimin e veprimtarive të përcaktuara në paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni në rastin e çfarëdo personi, i cili është i përfshirë në veprimtari që mund të shkaktojnë një konflikt interesi, ose që ka akses në informacione të brendshme ose në informacione të tjera konfidenciale në lidhje me klientët ose transaksionet me ose për klientët, në sajë të një veprimtarie që kryhet prej tij në emër të shoqërisë.
2. Shoqëritë komisionere duhet të sigurojnë që personat përkatës të mos kryejnë një transaksion personal, i cili plotëson të paktën një nga kriteret e mëposhtme:
 - (a) atij personi i ndalohet ta kryejë transaksionin sipas Rregullores në fuqi për “Abuzimin me Tregun”;
 - (b) kur gjatë kryerjes së transaksionit po keqpërdoret ose jepet një informacion konfidencial;
 - (c) bie ndesh ose mund të bjerë ndesh me një detyrim të shoqërisë komisionere sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje.
3. Shoqëritë komisionere duhet të sigurojnë që personat përkatës të mos këshillojnë apo rekomandojnë, përveçse gjatë rrjedhës normale të punësimit apo kontratës për shërbime, asnjë person tjetër që të kryejë një transaksion në instrumente financiare, i cili, nëse do të ishte transaksion personal i personit përkatës, do të mbulohej nga paragrafi (2) i këtij neni.
4. Shoqëritë komisionere sigurojnë që personat përkatës të mos i japin asnjë informacion ose opinion, përveçse në rrjedhën normale të punësimit ose kontratës së tij për shërbime, asnjë personi tjetër ku personi përkatës e di, ose në mënyrë të arsyeshme duhet ta dijë, se si rezultat i asaj dhënieje informacioni, personi tjetër do të ndërmerret ose mund të ndërmerret një nga hapat e mëposhtëm:
 - (a) të kryejë një transaksion në instrumente financiare, i cili, nëse do të ishte një transaksion personal i personit përkatës, do të mbulohej nga paragrafët (2) ose (3) të këtij neni;
 - (b) të këshillojë ose të kërkojë një person tjetër për të bërë një transaksion të tillë.
5. Procedurat e nevojshme sipas paragrafit (1) të këtij neni janë të tilla që të sigurojnë se:
 - (a) çdo person përkatës që mbulohet nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni është i vetëdijshëm për kufizimet në transaksionet personale dhe për masat e vendosura nga

shoqëria komisionere në lidhje me transaksionet personale dhe dhënien e informacioneve, në përputhje me paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

- (b) shoqëria informohet menjëherë për çdo transaksion personal që kryhet nga personi përkatës, qoftë me njoftim për atë transaksion ose me procedura të tjera që i mundësojnë shoqërisë të identifikojë transaksione të tilla;
- (c) mbahet evidencë për transaksionin personal që i njoftohet shoqërisë ose që identifikohet prej saj, duke përfshirë çfarëdo autorizimi ose ndalimi në lidhje me një transaksion të tillë.
- (d) Në rastin e marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm, shoqëria komisionere siguron që shoqëria, të cilës i është dhënë aktiviteti me kontraktim të jashtëm, mban një regjistër të transaksioneve personale që kryhen nga çfarëdo personi përkatës dhe ia jep ato informacione shoqërisë komisionere menjëherë sipas kërkesës.

Seksioni 9 **Delegimi i funksioneve**

Neni 17 **Kriteret e delegimit**

1. Në vijim të nenit 39, paragrafi (1) dhe (6) të Ligjit, një shoqëri komisionere nuk mund të delegojë sa vijon:
 - (a) funksionin e përputhshmërisë;
 - (b) funksionin e parandalimit të pastrimit të parave; dhe
 - (c) funksionin e administrimit të rrezikut.
2. Kur mbështetet në një palë të tretë për kryerjen e funksioneve operacionale, të cilat janë thelbësore për ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme dhe të kënaqshme për klientët dhe realizimin e veprimtarive të investimit në mënyrë të vazhdueshme dhe të kënaqshme, shoqëria komisionere siguron, se duhen ndërmarrë hapa të arsyeshme për të shmangur rrezikun operacional shtesë të panevojshëm. Transferimi i funksioneve të rëndësishme operacionale nuk mund të ndërmerret në mënyrë të tillë që të dëmtojë materialisht cilësinë e kontrollit të brendshëm dhe aftësinë e mbikëqyrësit për të monitoruar pajtueshmërinë e shoqërisë me të gjitha detyrimet.
3. Një funksion operacional konsiderohet si thelbësor ose i rëndësishëm kur një dështim ose mosrealizim në performancën e tij ka efekte materiale:
 - (a) në pajtueshmërinë e vazhdueshme të një shoqërie komisionere me kushtet e licencës ose detyrimet e tjera sipas Ligjit apo kësaj rregulloreje;
 - (b) në performancën e saj financiare, apo qëndrueshmërinë ose vazhdimësinë e shërbimeve dhe aktiviteteve të saj të investimit.
4. Pa cënuar statusin e çfarëdo funksioni tjetër, funksionet e mëposhtme nuk do të konsiderohen si thelbësore apo të rëndësishme për qëllimet e paragrafit (2) të këtij neni:
 - (a) ofrimi i shërbimeve këshillimore ndaj shoqërisë apo shërbime të tjera që nuk janë pjesë e aktivitetit të investimit në tituj, duke përfshirë ofrimin e këshillave ligjore për

- shoqërinë, trajnimin e personelit të shoqërisë, shërbimet e faturimit dhe sigurinë e ambienteve dhe personelit të shoqërisë;
- (b) blerja e shërbimeve të standardizuara, duke përfshirë shërbimet e informacionit të tregut dhe ofrimin e të dhënave që lidhen me çmimet.
5. Shoqëritë komisionere që delegojnë funksione thelbësore ose të rëndësishme operacionale janë plotësisht përgjegjëse për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të tyre sipas Ligjit dhe veprojnë në përputhje me kushtet e mëposhtme:
- (a) kontraktimi i jashtëm nuk mundëson delegimin e përgjegjësive të menaxhimit të lartë;
 - (b) marrëdhënia dhe detyrimet e shoqërisë komisionere ndaj klientëve të saj sipas kushteve të Ligjit nuk ndryshojnë;
 - (c) nuk cënohen kushtet mbi bazën e të cilave shoqëria komisionere është licencuar dhe vepron si e tillë.
 - (d) asnjë nga kushtet e tjera, në bazë të të cilave është dhënë licenca e shoqërisë, nuk duhet të hiqet ose modifikohet.
6. Shoqëritë komisionere tregojnë aftësinë, kujdesin dhe vigjilencën e duhur kur lidhin, menaxhojnë ose ndërpresin çfarëdo marrëveshje për kontraktimin e një ofruesi shërbimesh për funksione operacionale thelbësore ose të rëndësishme dhe ndërmarrin hapat e nevojshëm për të siguruar se përmbushen kushtet e mëposhtme:
- (a) ofruesi i shërbimit ka aftësinë, kapacitetin, burimet e mjaftueshme, strukturën e duhur organizative që mbështet kryerjen e funksioneve të deleguara, si dhe çdo autorizim të nevojshëm sipas Ligjit për të kryer funksionet e deleguara, në mënyrë të besueshme dhe profesionale;
 - (b) ofruesi i shërbimit kryen shërbimet e deleguara në mënyrë efikase dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kriteret rregullatore dhe për këtë qëllim shoqëria ka përcaktuar metoda dhe procedura për vlerësimin e standardit të performancës së ofruesit të shërbimit dhe për rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të shërbimeve që ofrohen nga ofruesi i shërbimit;
 - (c) ofruesi i shërbimit monitoron siç duhet kryerjen e funksioneve të deleguara dhe menaxhon në mënyrën e duhur rreziqet që lidhen me kontraktimin;
 - (d) ndërmerren veprimet e duhura kur duket se ofruesi i shërbimit mund të mos i kryejë funksionet në mënyrë efikase ose në përputhje me ligjet në fuqi dhe kriteret rregullatore;
 - (e) shoqëria komisionere mbikëqyr në mënyrë efikase funksionet ose shërbimet e kontraktuara dhe menaxhon rreziqet që lidhen me delegimin dhe për këtë qëllim shoqëria duhet të ketë ekspertizën dhe burimet e nevojshme për të mbikëqyruar funksionet e deleguara në mënyrë efikase dhe për të menaxhuar rreziqet;
 - (f) ofruesi i shërbimit i ka bërë të ditur shoqërisë komisionere çdo zhvillim që mund të ketë një ndikim material në aftësinë e saj për të kryer funksionet e deleguara në mënyrë efikase dhe në përputhje me ligjet në fuqi dhe kriteret rregullatore;
 - (g) shoqëria komisionere mund të ndërpresë marrëveshjen për delegimin kur është e nevojshme, me efekt të menjëhershëm kur kjo është në interes të klientëve të saj, pa dëmtuar vazhdimësinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve për klientët;
 - (h) ofruesi i shërbimit bashkëpunon me Autoritetin në lidhje me funksionet e deleguara;
 - (i) shoqëria komisionere siguron që audituesit e saj dhe Autoriteti të kenë akses efikas në të dhënat në lidhje me funksionet e deleguara, si dhe në mjediset përkatëse të biznesit

- të ofruesit të shërbimit, kur është e nevojshme me qëllim mbikëqyrjen efikase në përputhje me këtë nen;
- (j) ofruesi i shërbimit mbron çdo informacion konfidencial në lidhje me shoqërinë komisionere dhe klientët e saj;
 - (k) shoqëria komisionere dhe ofruesi i shërbimit duhet të kenë dhe zbatojnë një plan emergjence për rikuperimin nga fatkeqësitë dhe testimin periodik të procedurave “Back Up”, kur kjo është e nevojshme duke pasur parasysh funksionin, shërbimin ose aktivitetin që është deleguar;
 - (l) shoqëria komisionere siguron që edhe në rast të përfundimit të delegimit të ruhet vazhdimësia dhe cilësia e funksioneve ose shërbimeve të deleguara, qoftë duke transferuar funksionet ose shërbimet e deleguara te një palë tjetër e tretë ose duke i kryer ato vetë.
7. Të drejtat dhe detyrimet përkatëse të shoqërive komisionere dhe të ofruesit të shërbimit përcaktohen qartë përmes një marrëveshje me shkrim. Në mënyrë të veçantë, shoqëria komisionere rezervon të drejtën e saj për udhëzime dhe përfundim të marrëveshjes, si dhe të drejtat e saj për informacion apo të drejtën e saj për akses në librat dhe ambientet e ofruesit të shërbimit. Marrëveshja duhet të sigurojë që delegimi nga ofruesi i shërbimit të bëhet vetëm me pëlqimin, me shkrim, të shoqërisë komisionere.
8. Kur shoqëria komisionere dhe ofruesi i shërbimit janë anëtarë të të njëjtit grup, shoqëria komisionere, për qëllime të respektimit të këtij neni, merr parasysh masën në të cilën ajo kontrollon ofruesin e shërbimit ose ka aftësinë për të ndikuar në veprimet e tij.
9. Shoqëritë komisionere vënë në dispozicion të Autoritetit, me kërkesë të tij, të gjitha informacionet e nevojshme për t'i mundësuar Autoritetit mbikëqyrjen në përmbushjen e funksioneve të deleguara.

Neni 18

Kërkesat për politikën e delegimit

1. Shoqëria komisionere harton dhe dokumenton një politikë për delegimin e funksioneve, duke përfshirë planet përkatëse të emergjencës, strategjitë e daljes nga kontrata, si dhe kriteret e përgjithshme për delegimin në përputhje me Ligjin dhe këtë rregullore që mbulon të gjitha aspektet e delegimit, duke përfshirë delegimin jo-thelbësor ose jo të rëndësishëm dhe nëse delegimi kryhet brenda një grupi kompanish apo nga ofrues të jashtëm shërbimesh.
2. Politika e delegimit duhet të përfshijë fazat kryesore të ciklit jetësor të marrëveshjeve të delegimit dhe të përcaktojë parimet, përgjegjësitë dhe proceset në lidhje me delegimin.
3. Në mënyrë të veçantë, politika duhet të mbulojë të paktën:
 - (a) përgjegjësitë e Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës, duke përfshirë angazhimin e tij, sipas rastit, në vendimmarrjen për delegimin e funksioneve thelbësore ose të rëndësishme;
 - (b) përfshirjen e linjave të biznesit, funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe individëve të tjerë në lidhje me marrëveshjet e delegimit;
 - (c) planifikimin e marrëveshjeve të delegimit, duke përfshirë:

- (i) përcaktimin e kërkesave të shoqërisë në lidhje me marrëveshjet e delegimit;
 - (ii) kriteret dhe proceset për identifikimin e funksioneve thelbësore ose të rëndësishme;
 - (iii) identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut;
 - (iv) kontrollet e kujdesit të duhur për ofruesit e mundshëm të shërbimeve, duke përfshirë masat e marra;
 - (v) procedurat për identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe zbutjen e konflikteve të mundshme të interesit;
 - (vi) planifikimin e vazhdimësisë së biznesit;
 - (vii) procesin e miratimit të marrëveshjeve të reja të delegimit.
- (d) zbatimin, monitorimin dhe menaxhimin e marrëveshjeve të delegimit, duke përfshirë:
- (i) vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së ofruesit të shërbimit;
 - (ii) procedurat për t'u njoftuar dhe për t'iu përgjigjur ndryshimeve në një marrëveshje delegimi ose ofruesit të shërbimit;
 - (iii) analizën dhe auditimin e pavarur të përputhshmërisë me kriteret dhe politikat ligjore dhe rregullatore;
 - (iv) proceset e rinovimit;
 - (v) dokumentacionin dhe mbajtjen e të dhënave;
 - (vi) strategjitë e daljes dhe proceset e përfundimit, duke përfshirë një kriter për një plan daljeje të dokumentuar për çdo funksion thelbësor të rëndësishëm për t'u deleguar kur një dalje e tillë konsiderohet e mundshme, duke marrë parasysh ndërprerjet e mundshme të shërbimit ose përfundimin e papritur të një marrëveshjeje delegimi.
4. Politika e delegimit duhet të bëjë diferencimin ndërmjet sa vijon:
- (a) delegimit të funksioneve thelbësore ose të rëndësishme dhe marrëveshjeve të tjera të delegimit;
 - (b) delegimit tek ofruesit e shërbimeve që janë të autorizuar nga një autoritet kompetent ose Autoriteti dhe tek ata që nuk janë;
 - (c) marrëveshjet e delegimit brenda grupit dhe delegimet tek njësitë ekonomike jashtë grupit;
 - (d) delegimin tek ofruesit e shërbimeve të vendosura jashtë Republikës së Shqipërisë.
5. Shoqëritë komisionere duhet të sigurojnë se politika mbulon identifikimin e efekteve të mundshme të mëposhtme të marrëveshjeve thelbësore ose të rëndësishme të delegimit dhe se këto merren në konsideratë në procesin e vendimmarrjes:
- (a) profili i shoqërisë komisionere;
 - (b) aftësia për të mbikëqyrur ofruesin e shërbimit dhe për të menaxhuar rreziqet;
 - (c) masat për vazhdimësinë e biznesit; dhe
 - (d) performanca e veprimtarive të tyre tregtare.

Neni 19

Marrëveshjet e delegimit

1. Shoqëria komisionere siguron se çdo marrëveshje delegimi bazohet në një marrëveshje formale, të qartë dhe me shkrim, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet përkatëse të shoqërisë komisionere dhe të ofruesit të shërbimit.

2. Marrëveshja e delegimit duhet të përcaktojë të paktën:
- (a) përshkrimin e qartë të funksionit të deleguar që do të ofrohet;
 - (b) datën e fillimit dhe datën e përfundimit, sipas rastit, të marrëveshjes dhe periudhat e njoftimit për ofruesin e shërbimit dhe shoqërinë komisionere;
 - (c) ligjin që zbatohet për marrëveshjen;
 - (d) detyrimet financiare të palëve;
 - (e) nëse lejohet, nën-delegimi;
 - (f) vendndodhjen/t (d.m.th. rajonet ose vendet) ku do të ofrohet funksioni dhe/ose ku do të mbahen dhe përpunohen të dhënat përkatëse, duke përfshirë vendndodhjen e mundshme të ruajtjes dhe kushtet që duhen përmbushur, duke përfshirë një kriter për të njoftuar shoqërinë komisionere nëse ofruesi i shërbimit propozon ndryshimin e vendndodhjes/ve;
 - (g) aty ku është e përshtatshme, dispozitat në lidhje me aksesin, disponueshmërinë, integritetin, privatësinë dhe sigurinë e të dhënave përkatëse;
 - (h) të drejtën e shoqërisë komisionere për të monitoruar performancën e ofruesit të shërbimit në mënyrë të vazhdueshme;
 - (i) nivelet e dakordësuara të shërbimit, të cilat duhet të përfshijnë objektiva të sakta sasiore dhe cilësore të performancës për funksionin e deleguar për të lejuar monitorimin në kohë, në mënyrë që veprimet e duhura korrigjuese të mund të ndërmerren pa vonesa nëse nuk përmbushen nivelet e dakordësuara të shërbimit;
 - (j) detyrimet e raportimit të ofruesit të shërbimit ndaj shoqërisë komisionere, duke përfshirë komunikimin nga ofruesi i shërbimit për çdo zhvillim që mund të ketë efekt material në aftësinë e ofruesit të shërbimit për të kryer në mënyrë efektive funksionin në përputhje me nivelet e dakordësuara të shërbimit dhe në përputhje me ligjet në fuqi dhe kriteret rregullatore dhe, sipas rastit, detyrimet për të paraqitur raporte të funksionit të auditimit të brendshëm të ofruesit të shërbimit;
 - (k) nëse ofruesi i shërbimit duhet të marrë siguracion të detyrueshëm ndaj rreziqeve të caktuara dhe, nëse është e aplikueshme, niveli i mbulimit të kërkuar të siguracionit;
 - (l) kriteret për zbatimin dhe testimin e planeve të emergjencës së biznesit;
 - (m) dispozitat që sigurojnë se të dhënat që zotërohen nga shoqëria komisionere mund të aksesohen në rastin e paaftësisë paguese, zgjidhjes ose ndërprerjes së operacioneve të biznesit të ofruesit të shërbimit;
 - (n) detyrimi i ofruesit të shërbimit për të bashkëpunuar me Autoritetin ose me persona të tjerë të caktuar prej tyre;
 - (o) e drejta e pakufizuar e shoqërisë komisionere dhe Autoritetit për akses në ambjentet e ofruesit të shërbimit dhe në informacionin që lidhet në veçanti me funksionin e deleguar;
 - (p) të drejtat për përfundimin e marrëveshjes.

Seksioni 10 **Konflikti i interesit**

Neni 20 **Konfliktet e interesit që çënojnë interesin e klientit**

1. Të gjitha shoqëritë komisionere duhet të kenë sisteme, procedura dhe kontrolle për të identifikuar dhe parandaluar ose menaxhuar konfliktin ekzistues ose të mundshëm të interesit dhe transaksionet me palët e lidhura në dëm të interesit të klientit.

2. Shoqëritë komisionere krijojnë, zbatojnë dhe dokumentojnë një politikë të shkruar efikase për konfliktin e interesit në përputhje me madhësinë dhe organizimin e shoqërisë dhe natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit të saj.
3. Për qëllime të identifikimit të llojeve të konfliktit të interesit që lindin gjatë ofrimit të shërbimeve të investimit dhe atyre ndihmëse ose një kombinimi të tyre dhe ekzistenca e të cilave mund të dëmtojë interesat e një klienti, shoqëritë komisionere duhet të marrin parasysh, me anë të kritereve minimale, nëse shoqëria komisionere ose një person përkatës, ose një person i lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kontrolli me shoqërinë, është në ndonjë nga situatat e mëposhtme, qoftë si rezultat i ofrimit të investimeve ose shërbimeve ndihmëse ose aktiviteteve të investimit, ose ndryshe:
 - (a) shoqëria ose ai person mund të realizojë një fitim financiar ose të shmangë një humbje financiare, në ngarkim të klientit;
 - (b) shoqëria ose ai person ka interes në rezultatin e një shërbimi që i ofrohet klientit ose të një transaksioni që kryhet në emër të klientit, i cili është i ndryshëm nga interesi i klientit në atë rezultat;
 - (c) shoqëria ose ai person ka nxitje financiare ose nxitje tjetër për të favorizuar interesat e një klienti tjetër ose grupi tjetër klientësh mbi interesat e klientit;
 - (d) shoqëria ose ai person kryen të njëjtin biznes si klienti;
 - (e) shoqëria ose ai person merr ose do të marrë nga një person i ndryshëm nga klienti një nxitje në lidhje me një shërbim të ofruar për klientin, në formën e përfitimeve ose shërbimeve monetare ose jomonetare.
4. Kur shoqëria është anëtare e një grupi, politika do të marrë parasysh gjithashtu çdo rrethanë, për të cilën shoqëria është ose duhet të jetë në dijeni, të cilat mund të shkaktojnë një konflikt interesi që lind si rezultat i strukturës dhe aktiviteteve të biznesit të anëtarëve të tjerë të grupit.
5. Politika e konfliktit të interesit e përcaktuar në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni do të ketë këtë përmbajtje:
 - (a) ajo duhet të identifikojë, duke iu referuar shërbimeve dhe aktiviteteve specifike të investimit dhe shërbimeve ndihmëse që kryhen nga ose në emër të shoqërisë komisionere, rrethanat që përbëjnë ose mund të shkaktojnë një konflikt interesi që sjell rrezikun e dëmtimit të interesave të një ose më shumë klientëve;
 - (b) ajo duhet të specifikojë procedurat që duhen ndjekur dhe masat që duhen miratuar për të parandaluar ose menaxhuar konflikte të tilla.
6. Procedurat dhe masat e përmendura në pikën (b) të paragrafit (3) të këtij neni do të hartohen për të siguruar se personat përkatës të përfshirë në aktivitete të ndryshme biznesi që përfshijnë konflikt interesi i kryejnë ato aktivitete në një nivel pavarësie të përshtatshëm për madhësinë dhe aktivitetet e shoqërisë komisionere dhe të grupit të cilit i përket, si dhe rrezikun e dëmtimit të interesave të klientëve.
7. Për qëllimet e shkronjës (b) të paragrafit (3) të këtij neni, procedurat që do të ndiqen dhe masat që do të ndërmerren duhet të përfshijnë të paktën ato zëra në listën e mëposhtme, të cilat janë të nevojshme që shoqëria të sigurojë shkallën e nevojshme të pavarësisë:

- (a) procedura efikase për të parandaluar ose kontrolluar shkëmbimin e informacionit ndërmjet personave përkatës të përfshirë në aktivitete që përfshijnë rrezikun e një konflikti interesi, ku shkëmbimi i atij informacioni mund të dëmtojë interesat e një ose më shumë klientëve;
 - (b) mbikëqyrjen e veçantë të personave përkatës, funksionet kryesore të të cilëve përfshijnë kryerjen e aktiviteteve në emër të klientëve, interesat e të cilëve mund të bien ndesh, ose që përfaqësojnë interesa të ndryshme që mund të bien ndesh, duke përfshirë ato të shoqërisë;
 - (c) heqjen e çdo lidhjeje të drejtpërdrejtë midis shpërblimit të personave përkatës të angazhuar kryesisht në një aktivitet dhe shpërblimit ose të ardhurave të krijuara nga persona të ndryshëm përkatës të angazhuar kryesisht në një aktivitet tjetër, kur mund të lindë një konflikt interesi në lidhje me ato aktivitete;
 - (d) masa për të parandaluar ose kufizuar çdo person nga ushtrimi i ndikimit të papërshtatshëm mbi mënyrën sesi një person përkatës kryen investime ose shërbime ose aktivitete ndihmëse;
 - (e) masa për të parandaluar ose kontrolluar përfshirjen e njëkohshme ose të njëpasnjëshme të një personi përkatës në investime të veçanta ose shërbime ose aktivitete ndihmëse ku përfshirja e tillë mund të dëmtojë menaxhimin e duhur të konflikteve të interesit.
8. Shoqëritë komisionere do të sigurojnë se dhënia e informacioneve klientëve, është një masë e fundit që do të përdoret vetëm kur masat efikase organizative dhe administrative të vendosura nga shoqëria komisionere për të parandaluar ose menaxhuar konfliktet e saj të interesit nuk janë të mjaftueshme për të siguruar, me besim të arsyeshëm, se do të parandalohen rreziqet e dëmtimit të interesave të klientit.
9. Dhënia e informacioneve duhet të përcaktojë qartë se masat organizative dhe administrative të vendosura nga shoqëria komisionere për të parandaluar ose menaxhuar atë konflikt nuk janë të mjaftueshme për të siguruar, me besim të arsyeshëm, se do të parandalohen rreziqet e dëmtimit të interesave të klientit. Dhënia e informacioneve do të përfshijë një përshkrim specifik të konflikteve të interesit që lindin në ofrimin e investimeve dhe/ose shërbimeve ndihmëse, duke marrë parasysh natyrën e klientit të cilit i jepet informacioni. Përshkrimi duhet të shpjegojë natyrën e përgjithshme dhe burimet e konfliktit të interesit, si dhe risqet për klientin, të cilat lindin si rezultat i konfliktit të interesit dhe hapat që ndërmerren për të zbutur këto risqe, me detaje të mjaftueshme për t'i mundësuar atij klienti të marrë një vendim të informuar në lidhje me investimin ose shërbimin ndihmës në kontekstin e të cilit lindin konfliktet e interesit.
10. Shoqëritë komisionere do të vlerësojnë dhe shqyrtojnë periodikisht, të paktën një herë në vit, politikën e konflikteve të interesit të përcaktuar në përputhje me paragrafët (2) deri në (5) të këtij neni dhe do të marrin të gjitha masat e duhura për të adresuar çdo mangësi. Mbështetja e tepërt në zbulimin e konfliktit të interesit do të konsiderohet mangësi në politikën e konfliktit të interesit të shoqërisë komisionere.

Neni 21

Regjistrimi i shërbimeve ose aktiviteteve që shkaktojnë konflikt interesi

1. Shoqëria komisionere duhet të dokumentojë çdo konflikt interesi që sjell rrezikun e cënimit të interesave të një ose më shumë klientëve ose, që mund të lindë në rrjedhën e veprimtarisë tregëtare ose aktivitetit të vazhdueshëm.
2. Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës informohet të paktën një herë në vit përmes raporteve me shkrim për situatat e referuara në këtë nen.

Seksioni 11

Agjenti i lidhur

Neni 22

Detyrimet e shoqërisë komisionere ndaj agjentit të lidhur

1. Shoqëria komisionere mund të caktojë një agjent të lidhur, i cili, për llogari të saj, kryen veprimtaritë e mëposhtme:
 - (a) promovon shërbimet e shoqërisë komisionere;
 - (b) ofron shërbimet e shoqërisë komisionere;
 - (c) merr dhe transmeton urdhrat e klientëve ekzistues ose të mundshëm;
 - (d) hedh në treg instrumente financiare;
 - (e) jep këshilla në lidhje me instrumentet financiare dhe shërbimet e ofruara nga shoqëria komisionere.
2. Agjenti i lidhur i shoqërisë komisionere mund të kryejë vetëm atë ose ato shërbime investimi që lejohet të ushtrojë shoqëria komisionere, me të cilin është lidhur.
3. Kur shoqëria komisionere vendos të emërojë një agjent të lidhur, ajo mbetet plotësisht dhe pa kushte përgjegjëse për çdo veprim ose mosveprim nga ana e agjentit të lidhur. Shoqëria komisionere duhet të sigurojë që agjenti i lidhur kur kontakton ose përpara se të komunikojë me klientin ekzistues ose klientin e mundshëm, do t'i japë informacion mbi cilësinë në të cilën ai vepron dhe shoqërinë komisionere që ai përfaqëson.
4. Shoqëria komisionere monitoron aktivitetet e agjentit të lidhur në mënyrë që të sigurojë që ai vazhdon të veprojë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të kësaj rregulloreje.
5. Agjentët e lidhur regjistrohen në Regjistrin Publik të Autoritetit. Regjistri përditësohet rregullisht dhe vihet në dispozicion të publikut.
6. Shoqëritë komisionere, duhet të verifikojnë nëse agjentët e lidhur që kanë emëruar janë me reputacion të mirë dhe kanë njohuritë dhe kompetencën e duhur.
7. Shoqëritë komisionere, kur emërojnë agjentët e lidhur, marrin masat e duhura për të shmangur çfarëdo ndikimi negativ që mund të kenë aktivitetet e agjentit të lidhur në performancën e shoqërisë komisionere.

8. Shoqëria komisionere duhet të ndalojë emërimin ose veprimtarinë e agjentëve të lidhur sipas këtij neni, në rast se agjenti i lidhur ka shkelur dispozitat e Ligjit ose të kësaj rregulloreje.

Seksioni 12

Shërbimi i investimit online

Neni 23

Detyrimet e shoqërisë komisionere kur ofron shërbime investimi online

1. Shoqëritë komisionere të cilat ofrojnë shërbime investimi online nëpërmjet internetit ose aplikacioneve duhet të veprojnë në përputhje me kriteret e Ligjit dhe me këtë rregullore, si dhe me kriteret e përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni dhe të përfshijnë informacionet e përcaktuara në paragrafin (3) të këtij neni.
2. Kur shërbimi i investimit kryhet online nëpërmjet internetit, kriteret e mëposhtme duhet të plotësohen në çdo kohë:
 - (a) shoqëria komisionere do të ketë përgjegjësi të plotë për të gjithë informacionet e komunikuar ose të shfaqura në faqen e internetit ose aplikacionin e ofruar dhe për cilësinë e përgjithshme të çdo informacioni të tillë të dhënë, të komunikuar ose të shfaqur në të;
 - (b) shoqëria komisionere cakton personin e kontaktit për komunikimin me Autoritetin në lidhje me shërbimin e investimit që ofrohet online;
 - (c) personi i caktuar sipas shkronjës (b) të paragrafit (2) të këtij neni dhe çdo ndryshim i personit të caktuar i komunikohet menjëherë Autoritetit;
 - (d) shoqëria komisionere duhet të sigurojë se të gjitha të dhënat dhe informacionet që ofrohen dhe shfaqen në internet ose nëpërmjet aplikacionit janë të plota dhe vazhdimisht të përditësuara;
 - (e) shoqëria komisionere duhet të sigurojë se paralajmërimet dhe deklaratat e duhura mund të shikohen në të njëjtin format si pjesa tjetër e faqes së internetit ose aplikacionit dhe të jenë të dukshme për të gjithë klientët ekzistues ose klientët e mundshëm të saj;
 - (f) shoqëria komisionere duhet të bëjë të ditur rastet se kur klienti ekzistues i saj ose klienti i mundshëm largohet nga faqja e internetit ose aplikacioni në internet i shoqërisë komisionere mund të hyjë në një tjetër faqe interneti ose aplikacion, në rast se këto faqe janë të ndërlidhura.
3. Faqja e internetit ose aplikacioni duhet të përfshijë të paktën informacionet e mëposhtme:
 - (a) emrin, adresën dhe detajet e kontaktit të shoqërisë komisionere;
 - (b) një deklaratë se shoqëria komisionere është licencuar/regjistruar/njohur nga Autoriteti ose një autoritet tjetër kompetent;
 - (c) një listë të juridiksioneve, në të cilat shoqëria komisionere është e autorizuar të ofrojë shërbimin e saj të investimeve;

- (d) procedurat për depozitimin e ankesave dhe një përshkrim të procedurës për trajtimin e tyre në përputhje me nenin (1)2 të kësaj rregulloreje;
- (e) detajet e kontaktit të personit ose personave përgjegjës për ankesat e investitorit në shoqërinë komisionere;
- (f) një deklaratë për klientët ose klientët e mundshëm dhe në cilin vend ofrohet shërbimi i investimit nëpërmjet internetit ose përdorimit të një aplikacioni.

Neni 24

Kërkesat për ruajtjen e të dhënave për shërbimet online

1. Kur një shoqëri komisionere ofron shërbime investimi online nëpërmjet internetit ose përmes një aplikacioni dhe komunikon me një klient ose klient të mundshëm me mjete të tilla, ajo duhet të sigurojë se zbaton masat e duhura në mënyrë që të regjistrojë të gjitha informacionet që i jepen klientit ose klientit të mundshëm, duke përfshirë regjistrat me datat përkatëse të dhënies së informacioneve, në mënyrë që të demonstrojë se ajo vepron në përputhje me kriteret rregullatore të përcaktuara në Ligj dhe në këtë rregullore.
2. Shoqëria komisionere duhet të sigurojë se faqja e internetit ose aplikacioni përmban materialin e duhur udhëzues, i cili synon të udhëzojë klientët që janë të rinj në çdo shërbim investimi, duke përfshirë, ndër të tjera, natyrën dhe specifikat e këtyre shërbimeve dhe produkteve.
3. Shoqëria komisionere duhet të japë një shpjegim të qartë mbi kryerjen e shërbimit online dhe të publikojë informacion mbi rreziqet që paraqet investimi në produktet financiare përmes rrugëve të komunikimit elektronik si dhe të publikojë rezultatet e përgjithshme nga humbjet në rast të instrumenteve komplekse siç mund të jenë kontratat për diferencë.
4. Të publikojë materiale promovuese apo materiale trajnimi si dhe video demonstrative për funksionimin e platformës përmes së cilës ofrohet shërbimi.

KREU III

KUSHTET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË

SEKSIONI 1

Informacioni për Klientët

Neni 25

Kriteret e përgjithshme

1. Shoqëritë komisionere, kur ofrojnë shërbime investimi ose, sipas rastit, shërbime ndihmëse për klientët, duhet të veprojnë me ndershmëri, drejtësi dhe profesionalizëm në interesin më të mirë të klientit të tyre dhe në mënyrë të veçantë, duhet të veprojnë në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Shoqëritë komisionere të cilat krijojnë instrumente financiare, duhet të sigurojnë se instrumentet financiare krijohen/dizenjohen në mënyrë të tillë që të përmbushin nevojat e grupit të synuar të klientëve fundorë, se strategjia për shpërndarjen e instrumenteve financiare është në përputhje me klientët e synuar, për të cilët hidhen në treg instrumentet financiare dhe se shoqëria komisionere ndërmerr hapa të arsyeshëm për të siguruar se instrumenti financiar u shpërndahet klientëve të synuar dhe të identifikuar.

Neni 26

Kërkesa për informacion të drejtë, të qartë dhe jo keqinformues

1. Shoqëritë komisionere sigurojnë se të gjitha informacionet, përfshirë komunikimet e marketingut, që i drejtohen klientit ekzistues jo profesionist ose profesionist ose klientit të mundshëm profesionist ose jo profesionist, plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafët (2) deri në (8) të këtij neni.

2. Shoqëritë komisionere duhet të sigurojnë se informacionet e referuara në paragrafin (1) të këtij neni janë në përputhje me kushtet që vijojnë:

- (a) informacioni përfshin emrin e shoqërisë komisionere;
- (b) informacioni është i saktë dhe gjithmonë jep një orientim të drejtë dhe të dukshëm të çdo rreziku përkatës kur i referohet çfarëdo përfitimi të mundshëm të një shërbimi investimi ose instrumenti financiar;
- (c) informacioni është i mjaftueshëm dhe i paraqitur në një mënyrë që mund të kuptohet edhe nga anëtari i grupit me njohuri mesatare, të cilit i drejtohet;
- (d) informacioni që jepet duhet të jetë i tillë që mos të transformojë, zvogëlojë ose ekzagjerojë mesazhin që kërkohet të përcillet përmes deklaratave ose paralajmërimeve të rëndësishme;
- (e) informacioni paraqitet vazhdimisht në të njëjtën gjuhë në të gjitha format e informacionit dhe materialet e marketingut që i ofrohen secilit klient, përveç rastit kur klienti ka pranuar të marrë informacion në më shumë se një gjuhë;
- (f) informacioni është i përditësuar dhe i përshtatshëm për mjetet e përdorura të komunikimit.

3. Kur informacioni ka natyrë krahasimore mbi shërbimet e investimit ose shërbimet ndihmëse, instrumentet financiare ose personat që ofrojnë shërbime investime ose shërbime ndihmëse, shoqëritë komisionere sigurojnë se plotësohen kushtet e mëposhtme:

- (a) krahasimi është kuptimplotë dhe paraqitet në mënyrë të drejtë dhe të balancuar;
- (b) janë specifikuar burimet e informacionit të përdorur për krahasimin;
- (c) janë përfshirë faktet dhe supozimet kryesore të përdorura për të bërë krahasimin.

4. Kur informacioni përmban një tregues të performancës së mëparshme të një instrumenti financiar, një indeksi financiar ose një shërbimi investimi, shoqëritë komisionere duhet të sigurojnë se plotësohen kushtet e mëposhtme:

- (a) ai tregues nuk është tipari më i spikatur i komunikimit;
- (b) informacioni duhet të përfshijë performancën që mbulon 5 vitet e mëparshme, ose kur aktiviteti është më pak se 5 vite, të gjithë periudhën për të cilën është ofruar

- instrumenti financiar, është krijuar indeksi financiar ose është ofruar shërbimi i investimit dhe në çdo rast informacioni i performancës bazohet në periudha të plota 12-mujore;
- (c) periudha së cilës i referohet informacioni dhe burimi i informacionit tregohen qartë;
 - (d) informacioni përmban një paralajmërim të dukshëm se shifrat i referohen të shkuarës dhe se performanca e kaluar nuk është një tregues i besueshëm i rezultateve të ardhshme;
 - (e) kur treguesi mbështetet në shifra të shprehura në një monedhë të ndryshme nga monedha e vendit ku është rezident klienti jo profesionist ekzistues ose i mundshëm, monedha tregohet qartë, së bashku me një paralajmërim se kursi i këmbimit mund të rritet ose ulet si rezultat i luhatjeve të monedhës;
 - (f) kur treguesi bazohet në performancën bruto, duhet të bëhet i njohur edhe efekti i komisioneve, tarifave ose detyrimeve të tjera.
5. Kur informacioni përfshin ose i referohet performancës së simuluar të së kaluarës, shoqëritë komisionere sigurojnë se informacioni ka lidhje me një instrument financiar ose një indeks financiar dhe plotësohen kushtet e mëposhtme:
- (a) performanca e simuluar e kaluar bazohet në performancën faktike në të kaluarën të një ose më shumë instrumenteve financiare ose indekseve financiare, të cilët janë të njëjtë, ose në thelb janë të njëjtë, ose janë themeli i instrumentit financiar në fjalë;
 - (b) në lidhje me performancën faktike të kaluar të përmendur në shkronjën (a), kushtet e përcaktuara në shkronjat (a) deri (c), (e) dhe (f) të paragrafit (4) të këtij neni janë plotësuar;
 - (c) informacioni përmban një paralajmërim të qartë se shifrat i referohen performancës së simuluar të së shkuarës dhe se performanca e kaluar nuk është një tregues i besueshëm i performancës së ardhshme.
6. Kur informacioni përmban informacion mbi performancën e ardhshme, shoqëritë komisionere sigurojnë se plotësohen kushtet e mëposhtme:
- (a) informacioni nuk bazohet ose nuk i referohet performancës së mëparshme të simuluar;
 - (b) informacioni bazohet në supozime të arsyeshme të mbështetura nga të dhëna objektive;
 - (c) kur informacioni bazohet në performancën bruto, zbulohet efekti i komisioneve, tarifave ose detyrimeve të tjera;
 - (d) informacioni bazohet në skenarë performance në kushte të ndryshme tregu (si skenarë negativë ashtu edhe pozitivë), si dhe pasqyron natyrën dhe rreziqet e llojeve specifike të instrumenteve të përfshira në analizë;
 - (e) informacioni përmban një paralajmërim të dukshëm se parashikime të tilla nuk janë një tregues i besueshëm i performancës së ardhshme.
7. Kur informacioni i referohet një trajtimi të caktuar tatimor, ai duhet të përcaktojë qartë se trajtimi tatimor varet nga rrethanat individuale të secilit klient dhe mund të jetë subjekt i ndryshimit në të ardhmen.

8. Informacioni nuk duhet të përmbajë emrin e Autoritetit në mënyrë të tillë që do të tregonte miratim apo mbështetje prej tij të produkteve ose shërbimeve të shoqërisë komisionere.

Neni 27 Reklamat

1. Çdo reklamë që lidhet me ofertën e instrumenteve financiare, ose me çfarëdo shërbim apo veprimtari investimi duhet të jetë në përputhje me parimet e përfshira në paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni.
2. Informacionet e përfshira në reklamë duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafët (2) deri në (8) të nenit 26 të kësaj rregulloreje.
3. Të gjitha informacionet e dhëna në formë verbale ose me shkrim, edhe kur nuk janë dhënë për qëllime reklamimi, duhet të jenë në përputhje me nenin 26 të kësaj rregulloreje.
4. Reklama duhet të miratohet paraprakisht nga shoqëria komisionere përpara publikimit të saj.
5. Shoqëria komisionere harton procedura të brendshme në lidhje me reklamat dhe miratimin e tyre reklamave, dhe siguron se mënyra e shpërndarjes së reklamës është e përshtatshme.
6. Shoqëria komisionere siguron që të gjitha materialet reklamuese dhe promocionale, komunikimet dhe njoftimet për klientët që u dërgohen këtyre të fundit ose botohen në shtyp, ose në median elektronike publike, të jenë të qarta, të sakta, jo keqinformuese dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe rregulloreve të Autoritetit apo të autoritetit kompetent të një shteti tjetër në rastin e personit të njohur ose personit të licencuar ose të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që ushtron veprimtari në një vend tjetër.
7. Shoqëria komisionere mban të dhëna për të gjitha reklamat e bëra dhe të miratuara, duke përfshirë:
 - (a) një dokument në format elektronik të miratuar/nënshkruar nga njësia përgjegjëse e shoqërisë se çdo reklamë është në përputhje me kriteret e këtij neni dhe nenit 26 të kësaj rregulloreje;
 - (b) datën e miratimit të reklamave;
 - (c) vendin ku është publikuar reklama.

Neni 28 Informacion në lidhje me kategorizimin e klientëve

1. Shoqëria komisionere kategorizon klientët si palë të pranueshme, klientë profesionistë, klientë të kualifikuar ose klientë jo profesionistë në përputhje me kërkesat e nenit 3 dhe nenit 62 të Ligjit.

2. Shoqëritë komisionere njoftojnë klientët e rinj dhe klientët ekzistues për kategorizimin e tyre si palë të pranueshme, klient profesionist, klient jo profesionist ose klient të kualifikuar në përputhje me nenin 62 të Ligjit.
 3. Shoqëritë komisionere informojnë klientët, përmes mjeteve të qëndrueshme të komunikimit, lidhur me të drejtën që ka klienti:
 - (a) për të kërkuar një rikategorizim të ndryshëm dhe;
 - (b) për çdo kufizim që do të sillte një rikategorizim i ndryshëm në nivelin e mbrojtjes së klientit.
 4. Shoqëritë komisionere, me iniciativë të tyre ose me kërkesë të klientit me qëllim ofrimin e një niveli më të lartë mbrojtjeje, mund ta trajtojnë klientin si:
 - (a) klient profesionist ose jo profesionist, kur ai klient mund të ishte klasifikuar ndryshe si një kundërpalë e pranueshme në përputhje me nenin 30 të kësaj rregulloreje;
 - (b) klient jo profesionist kur ai klient është konsideruar si klient profesionist.
 5. Niveli më i lartë i mbrojtjes do të sigurohet kur një klient, i cili konsiderohet si profesionist apo palë e pranueshme, lidh një marrëveshje me shkrim me shoqërinë komisionere, e cila specifikon qëllimin për të cilin lidhet kjo marrëveshje si dhe nëse marrëveshja vlen për një ose më shumë shërbime investimi apo për një ose më shumë lloje instrumente financiare ose transaksione.
 6. Shoqëria komisionere duhet të informojë klientin profesionist mbi detyrimin e tij për të njoftuar shoqërinë në rast se ndryshojnë ngjarjet dhe rrethanat që e kategorizojnë atë si klient profesionist. Nëse shoqëria komisionere ka prova/informacion se klienti nuk përmbush më kushtet fillestare për të qenë klient profesionist apo palë e pranueshme, ajo duhet të marrë masat e duhura për rikategorizim të klientit dhe ta njoftojë atë me shkrim për këtë rikategorizim dhe arsyet e tij.
 7. Në përputhje me nenin 3 pika (16.3) të Ligjit, për kategorizimin si klient i kualifikuar ndiqet procedura e mëposhtme:
 - (a) klienti duhet t'i deklarojë me shkrim shoqërisë komisionere se dëshiron të trajtohet si klient profesionist në përgjithësi ose në lidhje me një shërbim apo transaksion të caktuar, ose me një lloj transaksioni ose produkti;
 - (b) shoqëria duhet t'i japë klientit një paralajmërim të qartë me shkrim lidhur me mbrojtjen dhe të drejtat e kompensimit të investitorit, që klienti mund t'i humbasë si rrjedhojë e cilësimit si klient i kualifikuar;
 - (c) klienti duhet të deklarojë me shkrim në një dokument të veçantë nga kontrata se është në dijeni të pasojave të humbjes së mbrojtjes që u ofrohet klientëve jo profesionistë.
- Kërkesat e këtij paragrafi gjejnë zbatim edhe për rikategorizimin e klientit si palë e pranueshme apo klient profesionist.
8. Kur klienti i një shoqërie komisionere kategorizohet si klient profesionist sipas Ligjit, shoqëria komisionere duhet ta informojë atë përpara çfarëdo ofrimi shërbimesh se, në bazë të informacionit që disponon shoqëria, klienti konsiderohet se është klient profesionist, si dhe do të trajtohet si i tillë, përveç rasteve kur shoqëria komisionere dhe klienti bien dakord ndryshe.

Shoqëria komisionere duhet gjithashtu të informojë klientin se ai mund të kërkojë një ndryshim të kushteve të marrëveshjes për të siguruar një nivel më të lartë mbrojtjeje.

9. Është përgjegjësi e klientit, të konsideruar si klient profesionist, që të kërkojë një nivel më të lartë mbrojtjeje kur mendon se nuk mund të vlerësojë ose menaxhojë siç duhet rreziqet e përfshira.

10. Gjithashtu për parashikimet e pikës (4) të këtij neni, shoqëria komisionere duhet të marrë deklaratën me shkrim dhe konfirmimin e klientit lidhur me kërkesën për t'u riklasifikuar në një kategori tjetër si dhe të informohet nga shoqëria mbi pasojat apo efektet që ka ky riklasifikim.

Neni 29

Procedurat dhe politikat për kategorizimin e klientëve

1. Shoqëria komisionere duhet të ketë dhe zbatojë procedura të brendshme të shkruara dhe të përshtatshme për kategorizimin e klientëve;

2. Procedurat e parashikuara në paragrafin (1) të këtij neni duhet të përmbajnë minimalisht:

- (a) llojet e kategorizimit të klientit sipas kërkesave të nenit 3 pika (16) dhe nenit 62 të Ligjit;
- (b) Njësinë përgjegjëse për kategorizimin e klientit;
- (c) mjetet në dispozicion të shoqërisë për kryerjen e kategorizimit të klientit në mënyrë të përshtatshme;
- (d) dokumentacioni që duhet të paraqesë klienti për kryerjen e kategorizimit apo riklasifikimit në një tjetër kategori;
- (e) procesi i komunikimit me klientit dhe njoftimet që i bëhen atij;
- (f) formate tip të paralajmërimeve dhe njoftimeve të përmendura në nenin 28 të kësaj rregulloreje;
- (g) procesin e rikategorizimit të klientit që nga paraqitja e kërkesës nga klienti deri në trajtimin e saj, përfshirë afatet kohore;
- (h) kërkesat që duhet të përmbushin klientët në rast të rikategorizimit në një kategori që siguron nivel më të lartë apo më të ulët mbrojtjeje, si dhe rastet kur ky kategorizim kryhet me iniciativë të vetë shoqërisë komisionere;
- (i) rastet kur shoqëria komisionere refuzon kërkesën e klientit për kategorizim/rikategorizim.

3. Shoqëria komisionere duhet të ketë mjetet e duhura organizative që i mundësojnë asaj klasifikimin e klientit në kategori në mënyrë të shpejtë dhe të lehtë. Gjithashtu shoqëria komisionere siguron se kategorizimi i bërë është i përshtatshëm për atë klient dhe se shërbimet e investimit në tituj janë ofruar apo do të ofrohen në përputhje me atë kategorizim.

4. Shoqëria komisionere mban regjistra/të dhëna për çdo klient lidhur me:

- (a) kategorizimin e tij, përfshirë dokumentacion që mbështet kategorizimin e bërë;
- (b) klientin që zgjedh të kategorizohet si klient profesionist, duke përfshirë dokumentin që evidenton përmbushjen e kërkesave ligjore për këtë kategorizim;
- (c) evidencën që klientit i është dërguar njoftimi apo paralajmërimi i parashikuar në nenin 28 të kësaj rregulloreje dhe një kopje e këtij njoftimi;
- (d) nëse i njëjti njoftim i është dërguar më shumë se një klienti, nuk është e nevojshme që të ruajë një kopje të njoftimit për çdo klient. Në këtë rast mjafton vetëm evidenca e parashikuar në pikën (c) të pikës (2) të këtij neni.

Neni 30

Informacione për shoqërinë komisionere dhe shërbimet e saj

1. Shoqëritë komisionere duhet t'u japin klientëve ekzistues ose klientëve të mundshëm informacionet e mëposhtme, sipas rastit:

- (a) emrin dhe adresën e shoqërisë komisionere, si dhe detajet e kontaktit të nevojshme për t'u mundësuar klientëve të komunikojnë në mënyrë efikase me shoqërinë;

- (b) gjuhën në të cilën klienti mund të komunikojë me shoqërinë dhe të marrë dokumente dhe informacione të tjera nga shoqëria;
- (c) metodat e komunikimit që do të përdoren ndërmjet shoqërisë komisionere dhe klientit, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, ato për dërgimin dhe marrjen e porosive;
- (d) një deklaratë për faktin se shoqëria komisionere është e licencuar dhe emrin dhe adresën e kontaktit të Autoritetit që e ka licencuar, si dhe Autoritetin që e ka regjistruar/njohur (kur është e aplikueshme);
- (e) informacion për faktin se shoqëria komisionere vepron nëpërmjet një agjenti të lidhur;
- (f) natyrën, frekuencën dhe kohën e raporteve për kryerjen e shërbimit që do të ofrohet nga shoqëria komisionere për klientin në përputhje me nenin 30 paragrafi (2) të kësaj rregulloreje;
- (g) kur shoqëria komisionere zotëron instrumente financiare të klientit ose fonde të klientit, një përshkrim përmbledhës të hapave që ajo ndërmerr për të siguruar mbrojtjen e tyre, duke përfshirë detajet përmbledhëse mbi skemën përkatëse të kompensimit të investitorit (nëse është e aplikueshme) që mund të gjejë zbatim për shoqërinë në bazë të aktiviteteve të saj;
- (h) një përshkrim, i cili mund të jepet në formë të përmbledhur, të politikës së konfliktit të interesit që zbatohet nga shoqëria komisionere në përputhje me nenin 20.

Informacionet e renditura në shkronjat (a) deri (h) të këtij paragrafi do të jepen në kohën e duhur përpara ofrimit të shërbimeve të investimit ose shërbimeve ndihmëse për klientët ekzistues ose klientët e mundshëm.

2. Kur ofron shërbime për administrimin e portofolit, shoqëria komisionere mund të përcaktojë një metodë të përshtatshme vlerësimi dhe krahasimi si një pikë referimi (*Benchmark*), nëse ka, bazuar në objektivat e investimit të klientit dhe llojet e instrumenteve financiare të përfshira në portofolin e klientit, në mënyrë që klienti, të cilit i ofrohet shërbimi, të mund të vlerësojë performancën e shoqërisë.
3. Kur shoqëritë komisionere propozojnë t'i ofrojnë një klienti ekzistues ose klienti të mundshëm shërbime për administrimin e portofolit, ato duhet t'i ofrojnë klientit, përveç informacionit të kërkuar sipas paragrafit (1) të këtij neni, edhe informacionet e mëposhtme:
 - (a) informacione mbi metodën dhe shpeshtësinë e vlerësimit të instrumenteve financiare në portofolin e klientit;
 - (b) detajet e çdo delegimi për menaxhimin diskrecional të të gjithë ose një pjese të instrumenteve financiare ose fondeve në portofolin e klientit;
 - (c) një specifikim të *Benchmark*, nëse ka, me të cilin do të krahasohet performanca e portofolit të klientit;
 - (d) llojet e instrumenteve financiare që mund të përfshihen në portofolin e klientit dhe llojet e transaksioneve që mund të kryhen në instrumente të tillë, duke përfshirë çfarëdo kufizimi;
 - (e) objektivat e menaxhimit, nivelin e riskut që duhet të marrë parasysh administratori i portofolit gjatë ushtrimit të diskrecionit dhe çdo kufizim specifik në diskrecionin e ushtruar.

Informacionet e renditura në shkronjat (a) deri (e) të këtij paragrafi do të jepen në kohën e duhur përpara ofrimit të shërbimeve të investimit ose shërbimeve ndihmëse për klientët ose klientët e mundshëm.

Neni 31 **Informacione për instrumentet financiare**

1. Shoqëritë komisionere duhet t'u ofrojnë klientëve ekzistues ose klientëve të mundshëm, përpara ofrimit të shërbimeve të investimit ose shërbimeve ndihmëse, një përshkrim të përgjithshëm të natyrës dhe risqeve të instrumenteve financiare, duke marrë parasysh, në mënyrë të veçantë, kategorizimin e klientit si klient jo profesionist, klient profesionist apo kundërpalë e pranueshme. Ky përshkrim duhet të shpjegojë natyrën e llojit specifik të instrumentit në fjalë, funksionimin dhe performancën e instrumentit financiar në kushte të ndryshme të tregut, duke përfshirë kushtet pozitive dhe negative, si dhe risqet e veçanta për atë lloj instrumenti specifik me detaje të mjaftueshme për t'i mundësuar klientit të marrë vendime të mirëinformuara investimi.
2. Përshkrimi i risqeve të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni duhet të përfshijë, kur është e rëndësishme për llojin specifik të instrumentit në fjalë dhe statusin dhe nivelin e njohurive të klientit, elementët e mëposhtëm:
 - (a) risqet që lidhen me atë lloj instrumenti financiar, duke përfshirë shpjegim mbi kapitalin e marrë hua dhe efektet e tij, si dhe rrezikun e humbjes së investimit, duke përfshirë risqet që lidhen me paaftësinë paguese të emetuesit ose ngjarje të lidhura me to, të tilla si garancia;
 - (b) luhatshmëria e çmimit të këtyre instrumenteve dhe çfarëdo kufizimi në tregun e disponueshëm për instrumente të tillë;
 - (c) informacione mbi pengesat ose kufizimet për mosinvestim, për shembull siç mund të jetë rasti për instrumentet financiare jolikuide ose instrumentet financiare me një afat fiks investimi, duke përfshirë një ilustrim të metodave të mundshme të daljes nga pozicioni dhe pasojave të çdo daljeje, kufizimet e mundshme dhe afatin kohor të vlerësuar për shitjen e instrumentit financiar përpara se të rikuperohen kostot fillestare të transaksionit në atë lloj instrumenti financiar;
 - (d) faktin që një investitor mund të marrë përsipër, si rezultat i transaksioneve në instrumente të tilla, angazhime financiare dhe detyrime të tjera shtesë, duke përfshirë detyrimet e mundshme, përveç kostos për blerjen e instrumenteve;
 - (e) çdo kërkesë për marzh ose detyrime të ngjashme, të zbatueshme për instrumentet e atij lloji.
3. Kur një shoqëri komisionere i ofron një klienti jo profesionist ekzistues ose klienti të mundshëm informacione në lidhje me një instrument financiar që është objekt i një oferte aktuale për publikun për të cilin është publikuar prospekti, shoqëria, përpara ofrimit të shërbimeve të investimit ose shërbimet ndihmëse për klientët ose klientët e mundshëm, duhet të informojë klientin ekzistues ose klientin e mundshëm se kur është vënë në dispozicion të publikut ai prospekt.
4. Kur një instrument financiar përbëhet nga dy ose më shumë instrumente ose shërbime të ndryshme financiare, shoqëria komisionere duhet të ofrojë një përshkrim të

përshtatshëm të natyrës ligjore të instrumentit financiar, përbërësve të atij instrumenti dhe mënyrës sesi ndërveprimi ndërmjet komponentëve të atij instrumenti ndikon në risqet e investimit.

5. Në rastin e instrumenteve financiare që përfshijnë një garanci ose mbrojtje të kapitalit, shoqëria komisionere duhet t'i ofrojë klientit ekzistues ose klientit të mundshëm, informacione në lidhje me qëllimin dhe natyrën e kësaj garancie ose mbrojtjeje të kapitalit. Kur garancia jepet nga një palë e tretë, informacioni në lidhje me garancinë duhet të përfshijë detaje të mjaftueshme për garantuesin dhe garancinë, për t'i mundësuar klientit ose klientit të mundshëm të bëjë një vlerësim të drejtë të garancisë.
6. Ky nen nuk zbatohet në rastin e titujve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Neni 32

Informacione në lidhje me ruajtjen e instrumenteve financiare të klientit ose fondeve të klientit

1. Shoqëria komisionere që zotëron instrumente financiare ose fonde që u përkasin klientëve u ofron këtyre klientëve ose klientëve të mundshëm informacione të specifikuar në paragrafët (2) deri në (6) të këtij neni, aty ku është e përshtatshme.
2. Shoqëria komisionere duhet të informojë klientin ose klientin e mundshëm se ku mund të mbahen instrumentet financiare ose fondet e atij klienti nga një palë e tretë në emër të shoqërisë komisionere dhe në lidhje me përgjegjësinë e shoqërisë komisionere sipas legjislacionit në fuqi për çdo veprim ose mosveprim të të tretëve dhe pasojat për klientin në rastin e paaftësisë paguese të palës së tretë.
3. Kur instrumentet financiare të klientit ose klientit të mundshëm, nëse lejohet nga legjislacioni në fuqi mbahen në një llogari 'omnibus' nga një palë e tretë, shoqëria komisionere duhet të informojë klientin për këtë fakt dhe të japë një paralajmërim të dukshëm për risqet që rezultojnë në këtë rast
4. Shoqëria komisionere informon klientin ekzistues ose klientin e mundshëm kur sipas legjislacionit në fuqi nuk është e mundur që instrumentet financiare të klientit që mbahen me një palë të tretë të jenë të identifikueshme veçmas nga instrumentet financiare në pronësi të asaj pale të tretë ose të shoqërisë komisionere dhe jep një paralajmërim të dukshëm për risqet që rezultojnë në këtë rast
5. Shoqëria komisionere informon klientin për ekzistencën dhe kushtet e çdo interesi ose barre me vlerë që shoqëria ka ose mund të ketë mbi instrumentet ose fondet financiare të klientit, ose çdo të drejtë kompensimi që ajo ka në lidhje me ato instrumente apo fonde. Kur është e aplikueshme, ajo do të informojë gjithashtu klientin për faktin se një depozitar mund të ketë një interes ose barrë sigurie ose të drejtë kompensimi në lidhje me ato instrumente ose fonde.
6. Shoqëria komisionere, përpara se të hyjë në transaksione financimi me tituj në lidhje me instrumentet financiare që mbahen prej saj në emër të një klienti, ose përpara se të përdorë ndryshe instrumente të tilla financiare për llogarinë e saj ose të një klienti tjetër duhet t'i ofrojë klientit, përpara përdorimit të këtyre instrumenteve, në një mjedis të qëndrueshëm, informacione të qarta, të plota dhe të sakta mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e shoqërisë

komisionere në lidhje me përdorimin e këtyre instrumenteve financiare, duke përfshirë kushtet për kthimin e tyre, si dhe risqet e përfshira.

Neni 33 **Informacione për kostot dhe tarifat përkatëse**

1. Për qëllime të ofrimit të informacionit për klientët për të gjitha shpenzimet dhe tarifat sipas nenit 35 paragrafi (1) të kësaj rregulloreje, shoqëritë komisionere duhet të respektojnë kriteret e detajuara në paragrafët (2) deri (9) të këtij neni.

Pa cenuar detyrimet e përcaktuara në nenin 35 paragrafi (1) të kësaj rregulloreje, shoqëritë komisionere që ofrojnë shërbime investimi për klientët profesionistë kanë të drejtë të pajtohen për një zbatim të kufizuar, me këta klientë, të kriterëve të detajuara që janë të përcaktuara në këtë nen. Shoqërië komisionere nuk do të lejohen të bien dakord për kufizime të tilla kur ofrohen shërbime këshillimi për investimet ose menaxhimin e portofolit ose kur, pavarësisht nga shërbimi i investimit të ofruar, instrumentet financiare përkatëse përfshijnë një derivativ.

Pa cenuar detyrimet e përcaktuara në nenin 35 paragrafi (1) të kësaj rregulloreje, shoqëritë komisionere që ofrojnë shërbime investimi për palët e pranueshme kanë të drejtë të bien dakord për një zbatim të kufizuar të kriterëve të detajuara që janë të përcaktuara në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur, pavarësisht nga shërbimi i ofruar i investimit, instrumentet financiare përkatëse përfshijnë një derivativ dhe pala e pranueshme synon t'ua ofrojë klientëve të saj.

2. Për dhënien e informacioneve “ex-ante” dhe “ex-post” mbi kostot dhe tarifat për klientët, shoqëritë komisionere duhet të llogarisin në mënyrë të agreguar sa vijon:
 - (a) të gjitha kostot dhe tarifat shoqëruese të shoqërisë komisionere ose palë të tjera ku klienti u është drejtuar palëve të tjera, për shërbim/e investimi dhe/ose shërbime ndihmëse që ofrohen për klientin; dhe
 - (b) të gjitha kostot dhe tarifat që lidhen me krijimin/dizenjimin dhe menaxhimin e instrumenteve financiare.

Kostot e referuara në shkronjat (a) dhe (b) janë të renditura në Shtojcën II të kësaj rregulloreje. Për qëllimet e shkronjës (a), pagesat e palëve të treta të marra nga shoqëritë komisionere në lidhje me shërbimin e investimit të ofruar për një klient do të renditen veçmas dhe kostot dhe tarifat e akumuluar do të mblidhen dhe shprehen si shumë në para ashtu edhe si përqindje.

3. Kur një pjesë e kostove dhe tarifave totale duhet të paguhet ose përfaqëson një shumë në monedhë të huaj, shoqëritë komisionere do të ofrojnë një tregues të monedhës së përfshirë dhe normave dhe kostove të aplikueshme për konvertimin e monedhës. Shoqëritë komisionere do të informojnë gjithashtu për masat në lidhje me pagesën ose veprime të tjera.
4. Detyrimi për të dhënë në kohë informacione të plota “ex-ante” për kostot dhe tarifat e përmbledhura në lidhje me instrumentin financiar dhe me investimin ose shërbimin

ndihmës të ofruar do të zbatohet për shoqëritë komisionere në situatat e mëposhtme kur shoqëria komisionere rekomandon ose tregton instrumente financiare për klientët.

5. Shoqëritë komisionere që nuk rekomandojnë ose marketojnë një instrument financiar për klientin duhet t'i informojnë klientët e tyre për të gjitha kostot dhe tarifat që lidhen me investimin dhe/ose shërbimin ndihmës të ofruar.
6. Kur më shumë se një shoqëri komisionere ofron shërbime investimi ose ndihmëse për klientin, çdo shoqëri komisionere duhet të japë informacion për kostot e investimit ose shërbimet ndihmëse që ofron. Shoqëria komisionere që rekomandon ose marketon për klientët e saj shërbimet që ofrohen nga një shoqëri tjetër, do të grumbullojë koston dhe tarifat e shërbimeve të saj së bashku me koston dhe tarifat e shërbimeve që ofrohen nga shoqëria tjetër. Shoqëria komisionere do të marrë në konsideratë kostot dhe tarifat që lidhen me ofrimin e shërbimeve të investimeve të tjera ose shërbimeve ndihmëse nga shoqëritë e tjera, tek të cilat ka drejtuar klientin.
7. Në rastin e llogaritjes së kostove dhe tarifave në bazë "ex-ante", shoqëritë komisionere do të përdorin kostot faktike të ndodhura si përafruese për kostot dhe tarifat e pritshme. Aty ku kostot aktuale nuk janë të disponueshme, shoqëria komisionere do të bëjë vlerësime të mbështetura në baza të arsyeshme të këtyre kostove. Shoqëritë komisionere duhet të shqyrtojnë supozimet "ex-ante" bazuar në përvojën "ex-post" dhe duhet të bëjnë rregullime në këto supozime, kur është e nevojshme.
8. Shoqëritë komisionere japin informacionet vjetore "ex-post" për të gjitha kostot dhe tarifat që lidhen si me instrumentin/et financiar/e dhe me shërbimet e investimit dhe ato ndihmëse ku ato kanë rekomanduar ose marketuar instrumentin/et financiar/e dhe kanë ose kanë pasur një marrëdhënie të vazhdueshme me klientin gjatë vitit. Një informacion i tillë do të bazohet në kostot e ndodhura dhe do të ofrohet në mënyrë të personalizuar.

Shoqëritë komisionere mund të zgjedhin t'u japin klientëve një informacion të tillë të përmbledhur mbi kostot dhe tarifat e shërbimeve të investimit dhe instrumenteve financiare së bashku me çdo raportim periodik ekzistues.

9. Shoqëritë komisionere do t'u ofrojnë klientëve të tyre nëpërmjet një ilustrimi efektin kumulativ të kostove mbi kthimin e investimit kur ofrojnë shërbime investimi. Një ilustrim i tillë duhet të jepet si "ex-ante", ashtu edhe "ex-post". Shoqëritë komisionere duhet të sigurojë se ilustrimi plotëson kriteret e mëposhtme:
 - (a) tregon efektin e kostove dhe tarifave të përgjithshme në kthimin e investimit;
 - (b) tregon çdo rritje ose luhate të parashikuar në kosto; dhe
 - (c) shoqërohet me një përshkrim të ilustrimit.

Seksioni 2 **Këshillimi për Investime**

Neni 34 **Informacione për Këshillimin për Investime**

1. Shoqëritë komisionere që ofrojnë këshillim të investimit në tituj duhet t'i shpjegojnë klientit gamën e instrumenteve financiare që mund të rekomandohen, përfshirë marrëdhënien e shoqërisë me emetuesit ose ofruesit e instrumenteve financiare.
2. Shoqëritë komisionere duhet të ofrojnë një përshkrim të llojeve të instrumenteve financiare të marra në konsideratë, gamën e instrumenteve financiare dhe ofruesve për çdo lloj instrumenti sipas fushës së shërbimit.
3. Kur gama e instrumenteve financiare të vlerësuara nga shoqëria komisionere që ofron këshilla investimi përfshin edhe instrumentet financiare të vetë shoqërisë komisionere ose ato të emetuara ose të ofruara nga shoqëritë që kanë lidhje të ngushta ose çfarëdo marrëdhënie tjetër të ngushtë juridike ose ekonomike me shoqërinë komisionere, si dhe emetues ose ofrues të tjerë që nuk janë të lidhur, shoqëria komisionere duhet të dallojë, për çdo lloj instrumenti financiar, gamën e instrumenteve financiare të emetuara ose të ofruara nga subjekte që nuk kanë asnjë lidhje me shoqërinë komisionere.
4. Shoqëritë komisionere që kryeinë një vlerësim periodik të përshtatshmërisë së rekomandimeve të dhëna duhet të bëjnë të njohur sa vijon:
 - (a) shpeshhtësinë dhe shtrirjen e vlerësimit periodik të përshtatshmërisë dhe kur është e nevojshme, kushtet që e nxisin atë vlerësim;
 - (b) shkallën, në të cilën informacionet e mbledhura më parë do t'i nënshtrohen rivlerësimit; dhe
 - (c) mënyrën sesi një rekomandim i përditësuar do t'i komunikohet klientit.
5. Shoqëritë komisionere që ofrojnë këshillim për investime duhet të përcaktojnë dhe zbatojnë një proces përzgjedhjeje për të vlerësuar dhe krahasuar një gamë të mjaftueshme instrumentesh financiare të disponueshme në treg, nëse është e mundur. Procesi i përzgjedhjes do të përfshijë elementët e mëposhtëm:
 - (a) numri dhe shumëllojshmëria e instrumenteve financiare të marra në konsideratë janë në përpjesëtim me objektin e shërbimeve të këshillimit për investime;
 - (b) numri dhe shumëllojshmëria e instrumenteve financiare të marra në konsideratë përfaqësojnë siç duhet instrumentet financiare të disponueshme në treg, nëse është e mundur;
 - (c) kriteret për përzgjedhjen e instrumenteve të ndryshme financiare përfshijnë të gjitha aspektet përkatëse si risqet, kostot dhe kompleksitetin, si dhe karakteristikat e klientëve të shoqërisë komisionere;
 - (d) të sigurojë se përzgjedhja e instrumenteve që mund të rekomandohen të mos jetë e njëanshme.

6. Shoqëria komisionere që ofron këshilla investimi, të fokusuar në kategori të caktuara ose në një gamë të caktuar instrumentesh financiare duhet të jetë në përputhje me kriteret e mëposhtme:
- (a) shoqëria duhet ta pozicionojë në treg veten në mënyrë të tillë që synon vetëm të tërheqë klientët me një preferencë për ato kategori ose gamë instrumentesh financiare;
 - (b) shoqëria duhet të marrë nga klientët konfirmimin se ata janë të interesuar vetëm të investojnë në kategorinë ose gamën e specifikuar të instrumenteve financiare; dhe
 - (c) përpara ofrimit të shërbimit, shoqëria duhet të sigurojë se shërbimi i saj është i përshtatshëm për çdo klient të ri në bazë të faktit se modeli i saj i biznesit përputhet me nevojat dhe objektivat e klientit, si dhe gamën e instrumenteve financiare që janë të përshtatshme për klientin. Kur ky nuk është rasti, shoqëria nuk duhet t'i ofrojë klientit një shërbim të tillë.

Seksioni 3 **Raportimi tek klientët**

Neni 35 **Detyrimi për raportim**

1. Informacionet e duhura në lidhje me shoqërinë komisionere dhe shërbimet e saj, instrumentet financiare dhe strategjitë e propozuara të investimit, vendet e ekzekutimit dhe të gjitha kostot dhe tarifatat përkatëse duhet t'u jepen në kohë klientëve ekzistues ose klientëve të mundshëm të shoqërisë. Këto informacione duhet të përfshijnë sa vijon:
- (a) kur ofrohen këshilla për investime, shoqëria komisionere duhet, në kohën e duhur përpara se të japë këshilla investimi, të informojë klientin:
 - (i) nëse këshilla bazohet në një analizë të gjerë ose më të kufizuar të llojeve të ndryshme të instrumenteve financiare dhe, në veçanti, nëse diapazoni është i kufizuar në instrumente financiare që jepen ose ofrohen nga kompani që kanë lidhje të ngushta me shoqërinë komisionere ose çfarëdo marrëdhënie të tjera juridike ose ekonomike, siç janë marrëdhëniet kontraktuale, aq të afërta sa përbëjnë rrezik për të dëmtuar pavarësinë e këshillimit të dhënë;
 - (ii) nëse shoqëria komisionere i ofron klientit një vlerësim periodik të përshtatshmërisë së instrumenteve financiare të rekomanduara për atë klient;
 - (b) informacioni mbi instrumentet financiare dhe strategjitë e propozuara të investimit duhet të përfshijë udhëzimet dhe paralajmërimet e duhura për risqet që lidhen me investimet në ato instrumente ose në lidhje me strategji të veçanta investimi dhe nëse instrumenti financiar është i destinuar për klientët me pakicë ose profesionistë/të kualifikuar;
 - (c) informacioni mbi të gjitha kostot dhe tarifatat shoqëruese duhet të përfshijë informacion në lidhje me investimet dhe shërbimet ndihmëse, duke përfshirë koston e këshillimit, kur është e nevojshme, koston e instrumentit financiar të rekomanduar ose të marketuar për klientin dhe mënyrën se si klienti mund të paguajë për atë, duke përfshirë gjithashtu çdo pagesë për palët e treta.

Informacioni për të gjitha kostot dhe tarifat, duke përfshirë kostot dhe tarifat në lidhje me shërbimin e investimit dhe instrumentin financiar, të cilat nuk janë shkaktuar nga risku i tregut, duhet të agregohet për të lejuar klientin të kuptojë koston e përgjithshme si dhe efektin kumulativ në kthimin e investimit dhe me kërkesë të klientit duhet të jepet një analizë e detajuar. Kur është i aplikueshëm, një informacion i tillë do t'i ofrohet klientit rregullisht, të paktën një herë në vit, gjatë kohëzgjatjes së investimit.

2. Shoqëria komisionere i ofron klientit raporte të përshtatshme për shërbimin e ofruar me mjete të qendrueshme komunikimi. Këto raporte do të përfshijnë komunikime periodike me klientët, duke marrë parasysh llojin dhe kompleksitetin e instrumenteve financiare të përfshira dhe natyrën e shërbimit që i ofrohet klientit dhe do të përfshijnë, aty ku është e zbatueshme, kostot që lidhen me transaksionet dhe shërbimet e ndërmarra në emër të klientit.

Kur jep këshilla për investime, shoqëria komisionere, përpara se të kryhet transaksioni, duhet t'i ofrojë klientit një deklaratë mbi përshtatshmërinë me mjete të qendrueshme komunikimi, duke specifikuar këshillat e dhëna dhe mënyrën se si ato këshilla përmbushin preferencat, objektivat dhe karakteristikat e tjera të klientit jo profesionist.

Kur marrëveshja për blerjen ose shitjen e një instrumenti financiar lidhet duke përdorur një mjet komunikimi në distancë që pengon dorëzimin paraprak të deklaratës së përshtatshmërisë, shoqëria komisionere mund të japë deklaratën me shkrim mbi përshtatshmërinë me mjete të qendrueshme komunikimi menjëherë pasi klienti të jetë i detyruar që të zbatojë çfarëdo marrëveshje, me kusht që të plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- (a) klienti ka pranuar të marrë deklaratën e përshtatshmërisë pa vonesa të pa nevojshme pas përfundimit të transaksionit; dhe
- (b) shoqëria komisionere i ka dhënë klientit mundësinë e shtyrjes së transaksionit për të marrë paraprakisht deklaratën mbi përshtatshmërinë.

Kur një shoqëri komisionere ofron shërbimin e administrimit të portofolit ose ka informuar klientin se do të kryejë një vlerësim periodik të përshtatshmërisë, raporti periodik duhet të përmbajë një deklaratë të përditësuar se si investimi plotëson preferencat, objektivat dhe karakteristikat e tjera të klientit jo profesionist.

3. Ky nen nuk zbatohet për titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Neni 36

Detyrimi për raportim në lidhje me ekzekutimin e urdhrave që janë të ndryshëm nga ato për administrimin e portofolit

1. Shoqëritë komisionere që ekzekutojnë një urdhër në emër të një klienti, por jo në kuadër të administrimit të portofolit, duhet që në lidhje me atë urdhër:
 - (a) t'i japin menjëherë klientit, me mjete të qendrueshme komunikimi, informacione thelbësore lidhur me ekzekutimin e atij urdhri;

- (b) t'i dërgojnë klientit një njoftim me mjete të qëndrueshme komunikimi, që konfirmon ekzekutimin e urdhrat sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se dita e parë e punës pas ekzekutimit ose, kur konfirmimi është marrë nga shoqëria komisionere nga një palë e tretë, jo më vonë se dita e parë e punës pas marrjes së konfirmimit nga pala e tretë.

Shkronja (b) nuk do të zbatohet kur konfirmimi përmban të njëjtin informacion si konfirmimi që do t'i dërgohet menjëherë klientit nga një person tjetër.

Shkronjat (a) dhe (b) nuk do të zbatohen kur urdhrat e ekzekutuar në emër të klientëve lidhen me obligacione që shërbejnë për financimin e marrëveshjeve të kredisë hipotekore me klientët e përmendur; në një rast të tillë raporti mbi transaksionin do të bëhet në të njëjtën kohë me komunikimin e kushteve të kredisë hipotekore, por jo më vonë se një muaj pas ekzekutimit të urdhrat.

2. Përveç kritereve në paragrafin (1) të këtij neni, shoqëritë komisionere i japin klientit, me kërkesë të tij, informacione për statusin e urdhrat të tij.
3. Në rastin e urdhrave të klientit në lidhje me kuota ose aksione në një Sipërmarrje të Investimeve Kolektive, të cilat ekzekutohen periodikisht, shoqëritë komisionere ose duhet të ndërmarrin veprimet e specifikuar në shkronjën (b) të paragrafit (1), ose t'i japin klientit, të paktën një herë në gjashtë muaj, informacionet e renditura në paragrafin (4) në lidhje me ato transaksione.
4. Njoftimi i referuar në shkronjën (b) të paragrafit (1) të këtij neni përfshin informacionet e mëposhtme, siç zbatohen:
 - (a) identifikimin e shoqërisë raportuese;
 - (b) emrin ose tituj të tjerë të klientit;
 - (c) ditën e tregtimit;
 - (d) kohën e tregtimit;
 - (e) llojin e urdhrat;
 - (f) identifikimin e vendit të tregtimit;
 - (g) identifikimin e instrumentit;
 - (h) treguesin nëse është veprim blerje/shitje;
 - (i) natyrën e urdhrat nëse është i ndryshëm nga blerje/shitje;
 - (j) sasinë;
 - (k) çmimin për njësi;
 - (l) shumën totale;
 - (m) një shumë totale të komisioneve dhe shpenzimeve të tarifuara dhe, kur klienti e kërkon këtë, një analizë të detajuar duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, shumën e çdo rritjeje ose uljeje të vendosur kur transaksioni është ekzekutuar nga një shoqëri komisionere, kur vepron për llogarinë e vet dhe shoqëria komisionere i detyrohet klientit të kryejë ekzekutimin më të mirë;
 - (n) kursin e këmbimit, kur transaksioni përfshin një konvertim të monedhës;
 - (o) përgjegjësitë e klientit në lidhje me shlyerjen e transaksionit, duke përfshirë afatin kohor për pagesën ose dorëzimin, si dhe detajet e duhura të llogarisë kur këto detaje dhe përgjegjësi nuk i janë njoftuar më parë klientit;

- (p) informim në rast se kundërpala e klientit ishte vetë shoqëria komisionere ose çfarëdo personi në grupin e shoqërisë komisionere ose një klient tjetër i shoqërisë komisionere, përveç situatave kur urdhri ishte ekzekutuar nëpërmjet një sistemi tregtimi që lehtëson tregtimin anonim.

Për qëllimet e shkronjës (k), kur urdhri ekzekutohet me pjesë “transhe”, shoqëria komisionere mund t’i japë klientit informacione për çmimin e çdo pjese ose çmimin mesatar. Kur jepet çmimi mesatar, shoqëria komisionere i jep klientit, me kërkesë të tij, informacione për çmimin e secilës pjese të urdhrin.

5. Shoqëria komisionere mund t’i ofrojë klientit informacionet e referuara në paragrafin (4) të këtij neni duke përdorur kode standarde me kushtin që të japë shpjegim për kodet e përdorura.

Neni 37

Detyrimi për raportim në lidhje me administrimin e portofolit

1. Shoqëritë komisionere që ofrojnë shërbimin e administrimit të portofolit për klientët duhet t’i ofrojnë secilit klient një deklaratë periodike, të paktën një herë në vit, me mjete të qëndrueshme komunikimi, të aktiviteteve të administrimit të portofolit, që kryhen në emër të atij klienti përveçse kur një deklaratë e tillë lëshohet nga një person tjetër.
2. Deklarata periodike sipas paragrafit (1) të këtij neni ofron një pasqyrim të drejtë dhe të balancuar të aktiviteteve të ndërmarra dhe të performancës së portofolit gjatë periudhës raportuese dhe përfshin, sipas rastit, informacionet e mëposhtme:
 - (a) emrin e shoqërisë komisionere;
 - (b) emrin ose tituj të tjerë të llogarisë së klientit;
 - (c) gjendjen e përmbytjes së portofolit dhe vlerësimit të tij, duke përfshirë detajet e çdo instrumenti financiar të mbajtur, vlerën e tij në treg ose vlerën e drejtë nëse vlera e tregut nuk është e disponueshme dhe bilancin e mjeteve monetare në fillim dhe në fund të periudhës raportuese, si dhe ecurinë e portofolit gjatë periudhës raportuese;
 - (d) shumën totale të tarifave dhe detyrimeve gjatë periudhës së raportimit, duke përcaktuar të paktën tarifave totale të administrimit dhe kostot totale që lidhen me ekzekutimin, si dhe duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, një deklaratë se një analizë më e detajuar do të jepet sipas kërkesës;
 - (e) një krahasim të performancës gjatë periudhës së mbuluar nga deklarata me një referencë krahasuese të performancës së investimit (Benchmark, nëse ka) të rënë dakord ndërmjet shoqërisë komisionere dhe klientit;
 - (f) shumën totale të dividendëve, interesit dhe pagesave të tjera të marra gjatë periudhës raportuese në lidhje me portofolin e klientit;
 - (g) informacion në lidhje me veprimet e tjera korporative që japin të drejta në lidhje me instrumentet financiare që mbahen në portofol;
 - (h) për çdo transaksion të kryer gjatë periudhës, informacionin e përmendur në nenin 31 të kësaj rregulloreje, kur është e nevojshme, përveç rasteve kur klienti zgjedh të marrë informacion në lidhje me transaksionet e kryera, transaksion pas transaksioni, ku në këtë do të zbatohet paragrafi (4) i këtij neni.

3. Deklarata periodike e referuar në paragrafin (1) të këtij neni jepet të paktën një herë në vit, me përjashtim të rasteve kur shoqëria komisionere u mundëson klientëve të saj akses në një sistem online, i cili cilësohet si mjet i qëndrueshëm komunikimi, ku mund të aksesohen vlerësimet e përditësuara të protofolit të klientit dhe shoqëria ka evidencë se klienti ka aksesuar një vlerësim të portofolit të tij të paktën një herë gjatë tremujorit përkatës;
4. Në rastet kur klienti zgjedh të marrë informacion për transaksionet e kryera, transaksion për transaksion, shoqëritë komisionere duhet t'i ofrojnë menjëherë klientit informacion mbi kryerjen e transaksionit nga administratori i portofolit, përmes një mjeti të qëndrueshëm komunikimi.

Shoqëria komisionere duhet t'i dërgojë klientit një njoftim që konfirmon transaksionin dhe përmban informacionin e përmendur në nenin 36 të kësaj rregulloreje, jo më vonë se dita e parë e punës pas atij ekzekutimi ose, kur konfirmimi është marrë nga shoqëria komisionere nga një palë e tretë, jo më vonë se dita e parë e punës pas marrjes së konfirmimit nga pala e tretë. Kjo nuk zbatohet kur konfirmimi përmban të njëjtin informacion si konfirmimi që i dërgohet menjëherë klientit nga një person tjetër.

Seksioni 4

Kërkesat për ofrimin e shërbimeve specifike të investimit

Neni 38

Kërkesat për shoqëritë komisionere që ofrojnë shërbimin e nënshkrimit të instrumenteve financiare

1. Shoqëria komisionere, përpara se të pranojë një mandat për të administruar ofertën, merr masa që sigurojë se i shpjegon sa vijon klientit që është emetuesi:
 - (a) alternativat e ndryshme të disponueshme të financimit dhe një tregues të shumës së tarifave të transaksionit që lidhen me secilën alternativë;
 - (b) kohën dhe procesin që do të ndërmarrë shoqëria komisionere në lidhje me vendosjen e çmimit të ofertës;
 - (c) kohën dhe procesin që do të ndërmarrë shoqëria në lidhje me mënyrën se si do të paraqitet oferta;
 - (d) detajet e llojit të investitorëve, të cilëve është planifikuar t'u ofrohen titujt;
 - (e) pozicionin e punës dhe departamentet e individëve përkatës të përfshirë në këshillat financiare lidhur me çmimin e ofertës dhe shpërndarjen e titujve tek individët; dhe
 - (f) sesi synon të parandalojë ose menaxhojë konfliktet e interesit që mund të lindin në rrethanat kur ofron titujt përkatës tek klientët ose në librin e vet tregtar.
2. Shoqëria komisionere duhet të ketë një proces të centralizuar për të identifikuar të gjitha veprimtaritë e nënshkrimit dhe hedhjes në treg të instrumentit financiar, si dhe regjistrimit të informacioneve që përfshijnë datën se kur shoqëria komisionere është informuar për veprimtaritë e mundshme të nënshkrimit dhe hedhjes në treg të instrumentit financiar.
3. Shoqëria komisionere duhet identifikojë të gjitha konfliktet e mundshme të interesit që lindin nga veprimtaritë e saj ose të grupit dhe zbaton procedura të përshtatshme të

menaxhimit të konfliktit të interesit. Në rast se shoqëria komisionere nuk mund të administrojë një konflikt interesi nëpërmjet zbatimit të procedurave të duhura, ajo nuk duhet të angazhohet në veprimtari.

4. Shoqëria komisionere që ofron shërbime të ekzekutimit të urdhërave dhe kryen veprimtari nënshkrimi të titujve duhet të sigurojë se ndërmerren masat e duhura për kontrollin dhe menaxhimin e çfarëdo konflikti të mundshëm interesi ndërmjet këtyre aktiviteteve dhe ndërmjet klientëve të tyre të ndryshëm që marrin këto shërbime.
5. Shoqëria komisionere duhet të ketë sisteme, kontrole dhe procedura për të identifikuar dhe menaxhuar konfliktet që lindin në lidhje me nënçmimin dhe mbiçmimin e mundshëm ose përfshirjen e personave në këtë proces, duke përfshirë mekanizmin e caktimit të çmimit “book building”:
 - (a) shoqëria komisionere informon dhe diskuton me emetuesin çdo strategji mbrojtëse ose stabilizimi që planifikon të ndërmarrë në lidhje me ofertën, duke përfshirë mënyrën sesi këto strategji mund të ndikojnë në interesat e klientit; dhe
 - (b) shoqëria komisionere ndërmerr hapa të arsyeshëm për ta mbajtur klientin të informuar mbi zhvillimet që lidhen me çmimet gjatë procesit të ofertës.
6. Shoqëria komisionere harton, zbaton dhe dokumenton rregulla të brendshme që parandalojnë që rekomandimet në lidhje me shërbimin e investimit të ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga asnjë marrëdhënie ekzistuese ose e ardhshme.
7. Shoqëria komisionere harton, zbaton dhe dokumenton rregulla të brendshme që menaxhojnë ose parandalojnë konfliktet e interesave që lindin kur personat përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të investimeve për klientët e saj janë të përfshirë drejtpërdrejt në vendimet që lidhen me rekomandime ndaj klientëve për alokimin e titujve.
8. Shoqëria komisionere nuk duhet të marrë stimuj nga palët e treta kur veprimet nuk konsiderohen si në interesin më të mirë të klientëve. Në veçanti do të konsiderohen të papranueshme rastet kur:
 - (a) gjatë ofertës fillestare publike alokimi i titujve nga shoqëria bëhet në mënyrë të tillë që të nxisë pagesën e tarifave të larta në mënyrë disproporcionale për shërbimet e ofruara nga shoqëria komisionere “laddering”, të tilla si tarifatat ose komisionet në mënyrë disproporcionale të larta të paguara nga klienti, ose vëllime në mënyrë disproporcionale të larta të biznesit për nivele normale komisioni që ofrohen nga klienti si kompensim për marrjen e një alokimi të emetuesit;
 - (b) gjatë ofertës fillestare publike shoqëria komisionere bën një alokim titujsh për një drejtues të lartë ekzekutiv ose një punonjësi të një emetuesi ekzistues ose të mundshëm, kur këta i kanë siguruar biznes apo i sigurojnë biznes në të ardhmen kësaj shoqërie komisionere “spinning”.
 - (c) kur alokimi bëhet, shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar, me kusht që klienti apo çdo entitet tjetër ku klienti është punonjës, të transmetojë urdhra tek kjo shoqëri komisionere apo të marrë çdo shërbim tjetër të ofruar prej saj.

9. Shoqëria komisionere duhet të ketë një politikë alokimi që përcakton procesin për dhënie e rekomandimeve të alokimit. Kjo politikë alokimi duhet t'i jepet emetuesit përpara se të bihet dakord për të hedhur në treg titujt. Politika, për aq sa është e njohur, duhet të përmbajë informacion për metodologjinë e propozuar të alokimit të titujve.
10. Shoqëria komisionere do të përfshijë emetuesin në diskutimet rreth procesit të hedhjes në treg të instrumenteve financiare, në mënyrë që shoqëria komisionere të mund të marrë parasysh interesat dhe objektivat e klientit. Shoqëria komisionere merr miratimin e emetuesit për alokimin e saj të propozuar që do të bëhet për çdo lloj klienti në përputhje me politikën e alokimit.
11. Shoqëria komisionere duhet të ketë procedura për kontrollin dhe identifikimin e menaxhimit të konfliktit të interesit që lind kur ajo i ofron klientit shërbime investimi për të marrë pjesë në një emetim, ndërkohë që ka përfituar komisione apo pëfitime të tjera monetare dhe jo monetare lidhur me organizimin e atij emetimi.

Neni 39

Mbajtja e regjistrimeve në lidhje me nënshkrimin dhe hedhjen në treg të instrumenteve financiare

1. Shoqëria komisionere duhet të mbajë të dhëna për përmbajtjen dhe kohën e udhëzimeve të marra nga klientët e saj.
2. Duhet të mbahet një regjistër i vendimeve të marra mbi alokimin për çdo operacion duke siguruar një gjurmë të plotë auditimi midis lëvizjeve të regjistruara në llogaritë e klientëve. Alokimi përfundimtar i realizuar për çdo klient duhet të arsyetohet dhe regjistrohet qartë.
3. Gjurma e plotë e auditimit të hapave materiale në procesin e nënshkrimit dhe hedhjes në treg të instrumentit financiar duhet t'i vihet në dispozicion Autoritetit, me kërkesë të tij.

Seksioni 5

Ekzekutimi më i mirë

Neni 40

Ekzekutimi më i mirë

1. Kur shoqëria komisionere tregton me një klient ose në emër të një klienti, ajo duhet të sigurojë ekzekutimin më të mirë.
2. Gjatë ekzekutimit të urdhrave shoqëria komisionere duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar rezultatet më të mira të mundshme për klientët, duke mbajtur parasysh çmimin, kostot, shpejtësinë, mundësitë e ekzekutimit dhe shlyerjes, madhësinë, natyrën ose çdo konsideratë tjetër të rëndësishme për ekzekutimin e urdhrat.

3. Shoqëria komisionere duhet t'i demonstrojë Autoritetit, sa herë që kërkohet prej tij, se ka ekzekutuar urdhrat e klientëve në përputhje me politikën e saj për ekzekutimin më të mirë dhe në pajtueshmëri me kërkesat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 41

Faktorët për Ekzekutimin më të mirë

1. Gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientëve, shoqëria komisionere mban parasysh kriteret e mëposhtme për të konstatuar rëndësinë relative të faktorëve:
 - (a) karakteristikat e klientit, përfshirë kategorizimin e klientit si klient “joprofesionist” ose klient “profesionist”;
 - (b) karakteristikat e urdhrat të klientit, përfshirë transaksionet e financimit me tituj;
 - (c) karakteristikat e instrumenteve financiare që janë objekt i urdhrat;
 - (d) karakteristikat e platformave të ekzekutimit ku mund të orientohet urdhri.
2. Shoqëria komisionere e përmbush detyrimin e parashikuar në këtë nen për ndjekjen e të gjithë hapave të duhur, në funksion të sigurimit të rezultatit më të mirë të mundshëm për klientin, për aq kohë sa e ekzekuton urdhrin ose një aspekt specifik të urdhrat në bazë të udhëzimeve specifike të klientit.
3. Shpejtësia, probabiliteti i ekzekutimit dhe i shlyerjes, madhësia dhe natyra e urdhrat, e veprimit të tregut dhe çdo kosto tjetër e nënkuptuar e transaksionit mund të marrë përparësi mbi konsideratat imediate të çmimit dhe kostos, vetëm për aq kohë sa janë të vlefshme për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm në përgjithësi për klientin jo profesionist.
4. Sa herë që klienti jep një udhëzim specifik, shoqëria duhet ta ekzekutojë urdhrin në bazë të këtij udhëzimi specifik dhe në këtë rast konsiderohet se është bërë ekzekutimi më i mirë. Megjithatë, shoqëria komisionere nuk duhet ta nxisë klientin që ta udhëzojë, ta ekzekutojë urdhrin në ndonjë mënyrë të veçantë, duke i sugjeruar klientit, shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar, përmbajtjen e udhëzimit, nëse nga shoqëria pritet në mënyrë të arsyeshme të dijë se një udhëzim i tillë ka të ngjarë të pengojë sigurimin e rezultatit më të mirë të mundshëm për klientin.
5. Kostot që lidhen me ekzekutimin përfshijnë komisionet ose tarifatat që shoqëria i ngarkon klientit për qëllime të kufizuara në rastet kur urdhri mund të ekzekutohet në më shumë se një nga platformat e renditura në rregulloren e shoqërisë komisionere për ekzekutimin.

Në raste të tilla mbahen parasysh komisionet e shoqërisë komisionere dhe kostot për ekzekutimin e urdhrat për secilën prej platformave të lejuara të ekzekutimit, në mënyrë që të vlerësohen dhe të krahasohen rezultatet që do të arriheshin për klientin nëse urdhri do të ekzekutohej në secilën prej tyre. Pavarësisht sa më sipër, shoqëria nuk është e detyruar të krahasojë rezultatet që do të arriheshin për klientin në bazë të procedurave të saj të ekzekutimit, komisioneve dhe tarifave të veta, me rezultate që mund të ishin arritur për të njëjtin klient nga ndonjë shoqëri tjetër komisionere në bazë të procedurave të tjera të ekzekutimit ose një strukture tjetër komisionesh ose tarifash. Gjithashtu, shoqëria nuk është e detyruar të krahasojë dallimet midis komisioneve të veta, të cilat shkaktohen nga dallimet e

natyrës së shërbimeve që shoqëria u ofron klientëve.

Neni 42

Procedura për Ekzekutimin më të mirë

1. Shoqëria komisionere duhet të miratojë dhe të zbatojë një rregullore të ekzekutimit të urdhrave, e cila i jep mundësi të sigurojë rezultatin më të mirë të mundshëm për ekzekutimin e urdhrave të klientëve. Shoqëria duhet t'ua komunikojë këtë rregullore klientëve, si më poshtë:

- (a) shoqëria komisionere duhet t'ua japë klientëve informacionin e duhur për rregulloren dhe procedurat e saj të ekzekutimit të urdhrave;
- (b) këto informacione duhet të shpjegojnë qartë se si do t'i ekzekutojë shoqëria urdhrat në emër të klientëve, duke përfshirë:

i. një listë të platformave të ekzekutimit tek të cilat shoqëria mbështetet në mënyrë të konsiderueshme në përmbushjen e detyrimit për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm për ekzekutimin e urdhrave të klientit. Në listë duhet specifikuar se cilat platforma ekzekutimi përdoren për secilën klasë të instrumenteve, për urdhrat e klientëve “jo profesionistë” apo për urdhrat e klientëve “profesionistë”;

ii. një listë të faktorëve të përdorur në përzgjedhjen e një platforme ekzekutimi, përfshirë faktorët cilësorë, siç janë skemat e klerimit, ndërprerësit e tregtimit automatik, veprimet e planifikuara ose ndonjë faktor tjetër të lidhur. Në listë duhet përcaktuar rëndësia relative e secilit faktor;

iii. informacion për faktorët e përdorur në përzgjedhjen e një platforme ekzekutimi duhet të përputhet me sistemin e kontrollit që përdor shoqëria, për t'ua dëshmuar klientëve se ekzekutimi më i mirë është arritur në mënyrë të vazhdueshme kur shqyrton përshtatshmërinë e procedurave dhe të masave të saj;

iv. mënyrën si merren në konsideratë faktorët e ekzekutimit të çmimit, të kostove, të shpejtësisë, të probabilitetit të ekzekutimit dhe çdo faktor tjetër i lidhur me to, në kuadër të të gjithë hapave të duhur që ndërmerren nga shoqëria për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm për klientin;

v. sipas rastit, informacion se shoqëria i ekzekuton urdhrat jashtë një platforme tregtimi. Ky informacion përfshin edhe pasojat që mund të rrjedhin nga ekzekutimi jashtë një platforme tregimi, si për shembull risku i kundërpalës. Me kërkesë të klientit, jepet informacion shtesë për pasojat e kësaj mënyre ekzekutimi;

vi. një paralajmërim të qartë dhe të dallueshëm se çdo udhëzim specifik i klientit mund ta pengojë shoqërinë në kryerjen e hapave të planifikuar në rregulloren e saj të ekzekutimit, për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm për ekzekutimin e urdhrat;

vii. një përmbledhje të procedurës së përzgjedhjes së platformave të ekzekutimit, strategjive të zbatuara për ekzekutimin, procedurave të ndjekura për të analizuar cilësinë e siguruar të ekzekutimit dhe të mënyrës si shoqëria monitoron dhe verifikon se janë siguruar rezultatet më të mira të mundshme për klientin.

2. Shoqëria komisionere duhet të monitorojë efektivitetin e procedurave të ekzekutimit të urdhrave për të identifikuar dhe, sipas rastit, për të ndrequr çdo mangësi. Në veçanti, shoqëria komisionere duhet të vlerësojë rregullisht nëse platformat e ekzekutimit të përfshira në

rregulloren për ekzekutimin e urdhrave sigurojnë rezultatin më të mirë të mundshëm për klientin ose nëse duhet të miratojë ndryshime në procedurat e ekzekutimit.

3. Shoqëritë komisionere rishikojnë të paktën një herë në vit, politikën e ekzekutimit më të mirë. Një rishikim i tillë duhet të kryhet gjithashtu sa herë që ndodh një ndryshim material që ndikon në aftësinë e shoqërisë për të vazhduar të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm për klientët e saj. Si ndryshim material do të konsiderohet një ngjarje e rëndësishme që mund të ndikojë në parametrat e ekzekutimit më të mirë si: kostoja, çmimi, shpejtësia, probabiliteti i ekzekutimit dhe shlyerja, madhësia, natyra ose çdo aspekt tjetër i rëndësishëm për ekzekutimin e urdhrat.

4. Shoqëria komisionere duhet të jetë në gjendje t'i demonstrojë klientit, me kërkesë të këtij të fundit, se urdhri është ekzekutuar në përputhje me rregulloren e shoqërisë komisionere për ekzekutimin e urdhrave dhe t'i demonstrojë Autoritetit, me kërkesën e këtij të fundit, se e ka zbatuar këtë nen.

5. Kur një rregullore e ekzekutimit të urdhrave e një shoqërie komisionere parashikon që urdhrat e klientit mund të ekzekutohen jashtë një tregu të rregulluar, shoqëria duhet t'i informojë klientët për këtë mundësi. Shoqëria komisionere duhet të marrë pëlqimin paraprak të klientëve përpara se të ndërmarrë procedurat e ekzekutimit të urdhrave të tyre jashtë një tregu të rregulluar. Pëlqimi i klientit mund të jepet në formën e një kontrate të përgjithshme ose veçmas për çdo transaksion specifik.

6. Nëse urdhri me kufi i klientit për shitblerjen e titujve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar nuk mund të ekzekutohet menjëherë në kushtet ekzistuese në treg, shoqëria komisionere merr masat për të ekzekutuar urdhrin sa më shpejt të jetë e mundur, nëse klienti nuk e udhëzon shprehimisht ndryshe. Masat e përmendura në këtë pikë të këtij neni përfshijnë bërjen publike, pa vonesë, të këtij urdhri në mënyrë që të mund t'u bëhet lehtësisht i ditur shoqërive të tjera komisionere. Shoqëria komisionere konsiderohet se e ka përmbushur detyrimin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni nëse i transmeton urdhrin me kufi të klientit sistemit të tregtimit të një tregu të rregulluar ose një platforme shumëpalëshe të tregtimit.

7. Shoqëria komisionere, kur ekzekuton urdhrat e klientit, duhet që për çdo klasë të instrumenteve financiare të bëjë publike çdo vit pesë vendet më të mira të tregëtimit përse i përket vëllimit të tregtimit, tek të cilat ka transmetuar urdhrat e klientit gjatë vitit paraardhës si dhe të japë informacion mbi cilësinë e ekzekutimit.

Seksioni 6 **Mbrojtja e aktiveve të klientit**

Neni 43 **Mbrojtja e pasurive të klientit dhe kujdestaria**

1. Shoqëritë komisionere të licencuara për të kryer shërbimin ndihmës, të specifikuar sipas shkronjës (a) të pikës (5) të nenit 3 të Ligjit, mund të kryejnë shërbimin e ruajtjes e të administrimit të instrumenteve financiare për llogari të klientëve të tyre.

2. Llogaritë në para të klientëve të shoqërisë komisionere mbahen pranë një banke të licencuar, të ndara veç nga aktivet e shoqërisë komisionere.
3. Shoqëria komisionere nuk mund të kryejë asnjë veprim tjetër me paratë e klientëve, përveç atij të urdhëruar nga klienti.
4. Shoqëria komisionere mund të përdorë paratë e klientëve vetëm për pagesën e detyrimeve në lidhje me shërbimet e investimeve dhe aktiviteteve që i ofron klientit dhe nuk mund t'i përdorë ato për pagesën e detyrimeve të klientëve të tjerë.
5. Paratë në llogaritë e klientëve nuk i përkasin shoqërisë komisionere dhe nuk janë pjesë e aktiveve të saj, ato nuk preken në rast likuidimi apo falimentimi të shoqërisë komisionere.
6. Paratë në llogaritë e klientëve nuk mund të përdoren për ekzekutimin e detyrimeve të shoqërisë komisionere.
7. Shoqëria komisionere mund të hapë një llogari titujsh në emër të saj me Depozitarin Qendror të Titujve.
8. Shoqëria komisionere mund të hapë një llogari klientësh në emër të klientëve me Depozitarin Qendror të Titujve, të veçantë nga llogaria e saj.
9. Shoqëria komisionere duhet të sigurohet që të gjitha veprimet e kryera në emër të klientëve për blerjet apo shitjet e titujve reflektohen te llogaria e titujve të klientëve, në përputhje me urdhrat e shlyerjes së transaksioneve.
10. Shoqëria komisionere mund të përdorë titujt e llogarisë së klientëve vetëm bazuar në urdhrat e klientëve.
11. Shoqëria komisionere duhet të sigurojë që përfitimi i gjeneruar nga huamarrja e titujve të klientëve i përket klientit. Shoqëria komisionere ka të drejtë të faturojë shërbimet e kontraktimit të huadhënies në përputhje me shumën e përcaktuar në listën e çmimeve të shoqërisë komisionere.
12. Shoqëria komisionere mban llogarinë e saj të titujve në një llogari pranë depozitarit qendror ose në rastin e instrumenteve financiare, të cilat mbahen jashtë llogarive të depozitarit qendror, të veçanta nga llogaritë e klientëve, me kusht që këta tituj mund t'i jepen hua klientit, nëse klienti autorizon shoqërinë komisionere për të marrë hua titujt në bazë të një kontrate apo autorizimi me shkrim.
13. Përfitimi i gjeneruar nga huamarrja e titujve të shoqërisë komisionere për një klient do t'i atribuohet shoqërisë komisionere. Shoqëria komisionere nuk mund të tarifojë klientin për huadhënien e titujve të shoqërisë komisionere.
14. Titujt e klientëve të shoqërisë komisionere nuk i përkasin shoqërisë komisionere dhe nuk janë pjesë e aktiveve të saj.
15. Titujt e klientëve të shoqërisë komisionere nuk i nënshtrohen procedurës së likuidimit apo

të falimentimit të shoqërisë komisionere.

16. Titujt e klientëve të shoqërisë komisionere nuk i nënshtrohen procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, me qëllimin e shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë komisionere.

17. Për qëllime të ruajtjes së të drejtave të klientëve në lidhje me instrumentet financiare dhe aktivet e klientëve, shoqëria komisionere duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- (a) duhet të mbajë regjistra dhe llogari kur është e nevojshme që t'i mundësojnë asaj në çdo moment të ndajë aktivet që i përkasin një klienti nga klienti tjetër;
- (b) duhet të mbajë regjistra dhe llogari në atë mënyrë që të sigurohet saktësia dhe në veçanti pronësia e instrumenteve financiare dhe fondeve të klientëve;
- (c) duhet të kryejë rregullisht kontrolle financiare dhe verifikime ndërmjet llogarive të saj të brendshme dhe regjistrave dhe ato të palëve të treta, aktivet e të cilëve mbahen në kujdestari;
- (d) duhet të ketë strukturë të mjaftueshme organizative për të siguruar që rreziku i humbjes së aktiveve të klientit është i minimizuar ose për të siguruar të drejtat në lidhje me këto aktive, si rezultat i keqpërdorimit, mashtrimit, administrimit të keq, mbajtjes së pamjaftueshme të regjistrave ose neglizhencës.

18. Në rastet kur aktivet e klientëve mbahen pranë një kujdestari të jashtëm, të sigurohet që këto aktive i transferohen për ruajtje një kujdestari të licencuar, në mënyrë të tillë që aktivet që u përkasin klientëve të veçantë të identifikohen në mënyrë të veçantë.

19. Shoqëria komisionere për sa më sipër ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm në zbatim të ligjit në fuqi "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".

20. Shoqëria komisionere që kryen shërbimin ndihmës të ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare duhet të informojë klientin mbi gjendjen e titujve të tij në kujdestari, me kërkesë të klientit dhe sa herë të ketë ndryshime në gjendjen e titujve.

21. Shoqëria komisionere mund të depozitojë instrumentet financiare të klientit te një palë e tretë në një vend të huaj, nëse ruajtja e instrumenteve financiare për llogari të një personi tjetër në shtetin e huaj i nënshtrohet rregullave dhe mbikëqyrjes së veçantë dhe pala e tretë mbulohet nga ato rregulla dhe mbikëqyrje.

22. Kur një vend i huaj nuk rregullon ruajtjen e instrumenteve financiare për llogari të një personi tjetër, shoqëria komisionere mund të depozitojë instrumente financiare të klientit me një palë të huaj në atë vend të huaj vetëm nëse, për shkak të natyrës së instrumenteve financiare përkatëse ose shërbimeve të investimit që lidhen me to, ruajtja mund të kryhet vetëm me atë palë të tretë ose një klient profesionist ka udhëzuar shoqërinë e shërbimeve të investimit në formë teksti që të depozitojë instrumentet financiare tek një palë e tretë në atë vend të huaj.

Seksioni 7 **Regjistrimi i të dhënave**

Neni 44 **Mbajtja e të dhënave**

1. Shoqëria komisionere organizon mbajtjen e të dhënave për të gjitha shërbimet, veprimtaritë dhe transaksionet e ndërmarra prej saj, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme për t'i mundësuar Autoritetit të përmbushë detyrat e tij mbikëqyrëse dhe të kryejë veprimet e zbatimit sipas rregullores, si dhe në veçanti, të konstatojë se shoqëria komisionere ka respektuar të gjitha detyrimet, duke përfshirë ato në lidhje me klientët ose klientët e mundshëm dhe me integritetin e tregut.

Të dhënat duhet të ruhen në një mjedis që lejon ruajtjen e informacionit në një mënyrë të aksesueshme nga Autoriteti, si dhe në formën dhe mënyrën që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- (a) Autoriteti mund t'i aksesojë ato lehtësisht dhe të mund t'i përdorë ato për të kuptuar çdo fazë kryesore të realizimit të transaksionit;
- (b) Të mundësohet që çdo korigjim ose ndryshim tjetër, si dhe përmbajtja e të dhënave para korigjimeve ose ndryshimeve të tilla, të konstatohet lehtësisht;
- (c) Të mos jetë e mundur që të dhënat të manipulohen ose ndryshohen;
- (d) lejon "TI" ose çdo përdorim tjetër efikas, kur analiza e të dhënave nuk mund të kryhet lehtësisht për shkak të vëllimit dhe natyrës së të dhënave; dhe
- (e) masat e shoqërisë janë në përputhje me kriteret e mbajtjes së të dhënave, pavarësisht nga teknologjia e përdorur.

Shoqëritë komisionere do të mbajnë të paktën të dhënat e identifikuara në shtojcën "I" të kësaj rregulloreje në varësi të natyrës së veprimtarive të tyre.

Lista e të dhënave të identifikuara në shtojcën "I" të kësaj rregulloreje nuk cenon asnjë detyrim tjetër për mbajtjen e të dhënave që rrjedh nga legjislacioni në fuqi.

2. Të dhënat që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet përkatëse të shoqërisë komisionere dhe klientit sipas një marrëveshjeje për të ofruar shërbime, ose kushtet në të cilat shoqëria i ofron shërbime klientit, do të ruhen të paktën gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies me klientin.
3. Në lidhje me çdo urdhër fillestar të marrë nga një klient dhe në lidhje me çdo vendim fillestar për tregtim, shoqëria komisionere, duhet menjëherë të mbajë të dhëna dhe të vendosë në dispozicion të Autoritetit të paktën detajet e përcaktuara në seksionin (1) të Aneksit III të kësaj rregulloreje në masën që ato janë të zbatueshme për urdhrin ose vendimin për tregtim.
4. Shoqëritë komisionere, menjëherë pas marrjes së urdhrin të klientit ose vendimit për tregtim, mbajnë të dhëna për veprimin në fjalë dhe i vendosin ato në dispozicion të Autoritetit me kërkesë të tij.
5. Shoqëritë komisionere krijojnë, zbatojnë dhe ruajnë një regjistrim efikas të bisedave telefonike (kur është e zbatueshme) dhe politikave të komunikimeve elektronike, të

përcaktuara me shkrim dhe të përshtatshme për madhësinë dhe organizimin e shoqërisë, si dhe natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit të saj.

6. Të dhënat do të përfshijnë regjistrimin e bisedave telefonike (kur është e zbatueshme) ose të komunikimeve elektronike që kanë të bëjnë, të paktën, me transaksionet e kryera kur merren për llogari të tyre dhe ofrimin e shërbimeve për urdhrat e klientit që kanë të bëjnë me marrjen, transmetimin dhe ekzekutimin e urdhrave të klientit.

Këto biseda telefonike dhe komunikime elektronike do të përfshijnë gjithashtu ato që synojnë të rezultojnë në transaksione të realizuara kur merren për llogari të tyre ose në ofrimin e shërbimeve për urdhrat e klientit që kanë të bëjnë me marrjen, transmetimin dhe ekzekutimin e urdhrave të klientit, edhe nëse ato biseda ose komunikime nuk rezultojnë në realizimin e transaksioneve të tilla ose në ofrimin e shërbimeve për urdhrat e klientit.

Për këto qëllime, shoqëria komisionere ndërmerr të gjitha hapat e arsyeshme për të regjistruar bisedat telefonike dhe komunikimet elektronike përkatëse, të bëra, të dërguara ose të marra nga pajisjet që ofrohen nga shoqëria komisionere për një punonjës ose kontraktor ose përdorimi i të cilave nga një punonjës ose kontraktor është pranuar ose lejuar nga shoqëria komisionere.

Shoqëria komisionere duhet të njoftojë klientët e rinj dhe ekzistues se do të regjistrohen komunikimet telefonike ose bisedat ndërmjet shoqërisë komisionere dhe klientëve të saj që rezultojnë ose mund të rezultojnë në transaksione.

Një njoftim i tillë mund të bëhet një herë përpara ofrimit të shërbimeve të investimit për klientët e rinj dhe ekzistues.

Shoqëria komisionere nuk duhet të ofrojë, nëpërmjet telefonit, shërbime dhe aktivitete investimi për klientët që nuk janë njoftuar paraprakisht për regjistrimin e komunikimeve ose bisedave të tyre telefonike, kur këto shërbime dhe veprimtari investimi kanë të bëjnë me marrjen, transmetimin dhe ekzekutimin e urdhrave të klientit.

Urdhrat mund të jepen nga klientët nëpërmjet kanaleve të tjera, megjithatë, komunikime të tilla duhet të realizohen me mjete të qendrueshme komunikimi, si p.sh. posta, fakse, email-e ose dokumentacion i urdhrave të klientëve në prani fizike. Në mënyrë të veçantë, gjatë shërbimit të këshillimit apo administrimit të portofolit përmbajtja e bisedave gjatë takimeve me prani fizike të klientit duhet të dokumentohet nga shoqëria.

Shoqëria komisionere duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshme për të parandaluar një punonjës ose kontraktor që të bëjë, dërgojë ose marrë biseda telefonike dhe komunikime elektronike përkatëse në pajisje private, të cilat shoqëria komisionere nuk mund t'i regjistrojë ose kopjojë.

Regjistrimet e mbajtura në përputhje me këtë paragraf do t'u jepen klientit të përfshirë sipas kërkesës dhe do të ruhen për një periudhë pesëvjeçare dhe kur kërkohet nga Autoriteti, për një periudhë deri në shtatë vjet.

7. Politika duhet të përfshijë përmbajtjen e mëposhtme:
 - (a) identifikimin e bisedave telefonike dhe komunikimeve elektronike, duke përfshirë bisedat përkatëse të brendshme telefonike dhe komunikimet elektronike, që u nënshtrohen kritereve të regjistrimit në përputhje me nenin 5 paragrafi (4) të kësaj rregulloreje dhe
 - (b) specifikimin e procedurave që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për të siguruar përputhshmërinë e shoqërisë me nënparagrafet e (3) dhe të (8) të nenit 5, paragrafit (4) të kësaj rregulloreje kur lindin rrethana të jashtëzakonshme dhe shoqëria nuk mund të regjistrojë biseda/komunikime në pajisjet e dhëna, të pranuar ose të lejuara nga shoqëria. Evidencat e këtyre rrethanave do të ruhen dhe do të jenë të aksesueshme për Autoritetin.
8. Shoqëritë komisionere do të sigurojnë se organi drejtues ka mbikëqyrje dhe kontroll efikas mbi politikat dhe procedurat që kanë të bëjnë me regjistrimin e bisedave telefonike dhe komunikimeve elektronike nga shoqëria.
9. Shoqëritë komisionere do të sigurojnë se masat për të vepruar në përputhje me kriteret e regjistrimit janë neutrale në aspektin e teknologjisë. Shoqëritë duhet të vlerësojnë në mënyrë periodike efikasitetin e politikave dhe procedurave të shoqërisë dhe të miratojnë çdo masë dhe procedurë alternative ose shtesë që është e nevojshme dhe e përshtatshme. Një miratim i tillë i masave alternative ose shtesë do të ndodhë, minimalisht, kur një mjedis i ri komunikimi pranohet ose lejohet për përdorim nga shoqëria.
10. Shoqëritë komisionere do të mbajnë dhe përditësojnë rregullisht një regjistër të atyre individëve që kanë pajisje të shoqërisë ose pajisje private që janë miratuar për përdorim nga shoqëria.
11. Shoqëritë komisionere do të përgatisin dhe aftësojnë punonjësit për procedurat që rregullojnë kriteret në nenin 5, paragrafi (4) i kësaj rregulloreje.
12. Për të monitoruar respektimin e kritereve për regjistrim dhe shënim në përputhje me nenin 5 paragrafi (4) të kësaj rregulloreje, shoqëritë komisionere do të monitorojnë periodikisht të dhënat e transaksioneve dhe urdhrave që u nënshtrohen këtyre kritereve, duke përfshirë bisedat përkatëse. Një monitorim i tillë duhet të bazohet në risk dhe të jetë proporcional.
13. Shoqëritë komisionere me kërkesë të Autoritetit depozitojnë politikat, procedurat dhe mbikëqyrjen e menaxhimit të rregullave të regjistrimit.
14. Përpara se shoqëritë komisionere të ofrojnë shërbime investimi dhe veprimtari në lidhje me marrjen, transmetimin dhe ekzekutimin e urdhrave për klientët e rinj dhe ekzistues, shoqëritë duhet të informojnë klientin për sa vijon:
 - (a) se bisedat dhe komunikimet regjistrohen (kur është aplikueshme); dhe
 - (b) se një kopje e regjistrimit të bisedave të tilla me klientin dhe e komunikimeve me klientin do të jetë e disponueshme, me kërkesë, për një periudhë pesëvjeçare dhe kur kërkohet nga Autoriteti, për një periudhë deri në shtatë vjet.Informacionet e referuara në nënparagrafin e (1) do të paraqiten në të njëjtën gjuhë si ajo e përdorur për të ofruar shërbime investimi për klientët.

(c) Shoqëritë komisionere gjatë takimit me prani fizike të klientit dokumentojnë të paktën sa vijon:

- (i) datën dhe orën e takimit;
- (ii) vendndodhjen e takimit;
- (iii) identitetin e pjesëmarrësve;
- (iv) iniciatorin e takimit; dhe
- (v) informacionet përkatëse në lidhje me urdhrin e klientit duke përfshirë çmimin, vëllimin, llojin e urdhrin dhe kur do të transmetohet ose ekzekutohet ai.

15. Të dhënat ruhen me mjete të qëndrueshme të komunikimit, që lejojnë rishikimin ose kopjimin e tyre dhe duhet të ruhen në një format që nuk lejon ndryshimin ose fshirjen e të dhënave fillestare.

Të dhënat duhet të ruhen në një mjedis, në mënyrë që ato të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të disponueshme për klientët sipas kërkesës.

Shoqëritë duhet të sigurojnë cilësinë, saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të të gjitha regjistrimeve telefonike (kur është e zbatueshme) dhe komunikimeve elektronike.

KREU IV

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËR SHOQËRITË KOMISIONERE

Neni 45

Raportimi i transaksioneve

Shoqëritë komisionere duhet të raportojnë transaksionet e kryera në përputhje me kërkesat e parashikuara në këtë kre.

Neni 46

Raportimi i pas-tregëtimit të transaksioneve në aksione, dëftesa të depozitarit, ETF, certifikata dhe instrumente të tjera financiare të ngjashme

1. Shoqëritë komisionere, të cilat për llogari të tyre ose për llogari të klientëve, kryejnë transaksione në aksione, dëftesa depozitari, ETF, certifikata dhe instrumente të tjera financiare të ngjashme që tregtohen në një vend tregtimi, duhet të bëjnë publike vëllimin dhe çmimin e këtyre transaksioneve dhe kohën në të cilën janë kryer.
2. Çdo transaksion, i kryer nga shoqëria komisionere jashtë një tregu të rregulluar/PSHT/POT, si dhe çdo transaksion i kryer nga çdo internalizues sistematik bëhet publik menjëherë përmes një sistemi/qendre të vetme të miratuar për publikimin e këtyre transaksioneve ("APA" - *Approved Publication Arrangement*). Kjo qendër/sistem ofron shërbimin e publikimit të transaksioneve të tregëtimit në emër të shoqërisë komisionere dhe mund të operohet nga vetë Autoriteti apo një shoqëri që miratohet prej tij për këtë qëllim.

3. Informacioni që bëhet publik në përputhje me paragrafin (1) dhe (2) të këtij neni duhet të jetë teknikisht sa më afër kohës reale të kryerjes së transaksionit.
4. Transaksionet në titujt e Qeverisë Shqiptare bëhen publike përmes platformës së administruar nga Autoriteti, sipas kërkesave të “Shtojcës IV” të kësaj rregulloreje.

Neni 47

Raportimi pas-tregëtimit të transaksioneve në obligacione, produkte të strukturuar financiare, kuotat e lejuara për çlirimin e gazrave serrë dhe instrumentet derivative

1. Shoqëritë komisionere, të cilat për llogari të tyre ose për llogari të klientëve, kryejnë transaksione në obligacione, produkte të strukturuar financiare, kuotat e lejuara për çlirimin e gazrave serrë dhe instrumente derivative që tregtohen në një vend tregtimi duhet të bëjnë publike vëllimin dhe çmimin e këtyre transaksioneve dhe kohën në të cilën janë kryer këto transaksione.

Çdo transaksion, i kryer nga shoqëria komisionere jashtë një tregu të rregulluar/PSHT/POT, si dhe çdo transaksion i kryer nga çdo internalizues sistematik bëhet publik menjëherë përmes një sistemi/qendre të vetme të miratuar në përputhje me nenin 46 paragrafi (2) të kësaj rregulloreje, për publikimin e këtyre transaksioneve.

2. Informacioni që bëhet publik në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni duhet të jetë teknikisht sa më afër kohës reale të kryerjes së transaksionit.

Neni 48

Detyrimi për raportim të transaksioneve

1. Shoqëritë komisionere që kryejnë transaksione në instrumente financiare duhet t'i raportojnë Autoritetit detajet e plota dhe të sakta të transaksioneve të tilla sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se në fund të ditës pasardhëse së punës.
2. Detyrimi i parashtruar në paragrafin (1) të këtij neni do të zbatohet për:
 - (a) instrumente financiare që pranohen për tregtim ose tregtohen në një vend tregtimi ose për të cilat është bërë një kërkesë për pranim për tregtim;
 - (b) instrumente financiare ku aktivi bazë është një instrument financiar që tregtohet në një vend tregtimi; dhe
 - (c) instrumente financiare ku baza është një indeks ose një shportë që përbëhet nga instrumente financiare të tregtuara në një vend tregtimi.

Detyrimi do të zbatohet për transaksionet në instrumentet financiare të përmendura në shkronjat (a) deri në (c) pavarësisht nëse këto transaksione kryhen ose jo në vendin e tregtimit.

3. Raportimi duhet të përfshijë, në mënyrë të veçantë, detaje të llojit të instrumentit financiar dhe sasinë, datën, e kohën e ekzekutimit, çmimet e transaksionit, një përshkrim që

identifikon klientët në emër të të cilëve shoqëria komisionere ka ekzekutuar atë transaksion, një përshkrim që identifikon personat dhe algoritmet kompjuterike brenda shoqërisë komisionere përgjegjëse për vendimin e investimit dhe ekzekutimin e transaksionit, nëse është e zbatueshme.

4. Shoqëritë komisionere, të cilat transmetojnë urdhra do të përfshijnë në transmetimin e atij urdhri të gjitha detajet, ashtu siç specifikohen në paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni.
5. Raportimi për Autoritetin kryhet nga vetë shoqëria komisionere.
6. Shoqëritë komisionere kanë përgjegjësi për plotësinë, saktësinë dhe dorëzimin në kohë të raporteve, të cilat i dorëzohen Autoritetit.
7. Shoqëritë komisionere duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshme për të verifikuar plotësinë, saktësinë dhe afatet kohore të raporteve të transaksioneve, të cilat janë dorëzuar në emër të tyre.

KREU V

Neni 49 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 01.01.2024.

SHTOJCA I

Mbajtja e të dhënave

Lista minimale e të dhënave që duhet të mbahen nga shoqëritë komisionere në varësi të natyrës së veprimtarive të tyre

Natyra e detyrimit	Lloji i të dhënave	Përmbledhje e përmbajtjes
--------------------	--------------------	---------------------------

Vlerësimi i klientit

Informacione për klientët	Përmbajtja siç parashikohet në nenin 26 dhe 28 të kësaj rregulloreje
Marrëveshjet me klientin	Të dhënat siç jepen në nenin 32 të kësaj rregulloreje
Vlerësimi i përshtatshmërisë	Përmbajtja siç jepet në nenin 36 të kësaj rregulloreje

Përpunimi i urdhrave

Përpunimi i urdhrave të klientit –Transaksionet e grumbulluara	Të dhënat siç jepen në nenet 42 dhe 43 të kësaj rregulloreje
Akumulimi dhe shpërndarja e transaksioneve për llogari të veta	Të dhënat siç jepen në nenin 43 të kësaj rregulloreje

Raportimi tek klientët

Detyrimi në lidhje me shërbimet e ofruara për klientët	Përmbajtja siç jepet në nenin 32 të kësaj rregulloreje
--	--

Ruajtja e aktiveve të klientit

Instrumentet financiare të klientit që mbahen nga një shoqëri komisionere	Të dhënat siç jepen në nenin 45 të kësaj rregulloreje
Fondet e klientit që mbahen nga një shoqëri komisionere	Të dhënat siç jepen në nenin 45 të kësaj rregulloreje

Komunikimi me klientët

Informacion në lidhje me kostot dhe tarifat përkatëse	Përmbajtja siç jepet në nenin 35 të kësaj rregulloreje
Informacion në lidhje me shoqërinë komisionere dhe shërbimet e saj, instrumentet financiare dhe mbrojtjen e aktiveve të klientit	Përmbajtja siç jepet në nenet 32 deri në 34 të kësaj rregulloreje
Informacione për klientët	Të dhënat e komunikimit
Këshilla investimi për klientët	(i) Fakti, ora dhe data kur janë dhënë këshillat për investime

me pakicë	dhe (ii) instrumenti financiar që është rekomanduar (iii) raporti i përshtatshmërisë që i është ofruar klientit
-----------	---

Kritere organizative

Biznesi dhe organizimi I brendshëm i shoqërisë	Të dhënat siç jepen në nenin 6 paragrafi (1) shkronja (f) të kësaj rregulloreje
Raportet e pajtueshmërisë	Çdo raport pajtueshmërie tek organi drejtues
Regjistrimi i Konfliktit të Interesit	Të dhënat siç jepen në nenin 20 të kësaj rregulloreje
Stimujt	Informacioni u jepet klientëve sipas nenit 20 dhe nenit 21 të kësaj rregulloreje
Raportet për menaxhimin e rrezikut	Çdo raport për menaxhimin e rrezikut tek menaxhimi i lartë
Raportet e auditimit të brendshëm	Çdo raport i auditimit të brendshëm tek menaxhimi i lartë
Regjistrimet e trajtimit të ankesave	Çdo ankesë dhe masat e trajtimit të ankesave të marra për të adresuar ankesën
Regjistrimet e transaksioneve personale	Të dhënat siç jepen në nenin 16 të kësaj rregulloreje

SHTOJCA II

Kostot dhe tarifat

Kostot e identifikuara që duhet të jenë pjesë e kostove që duhet t'u jepen klientëve (1)

Tabela 1 — Të gjitha kostot dhe tarifat shoqëruese për shërbimin/et e investimit dhe/ose shërbimet ndihmëse që ofrohen për klientin.

Zërat e kostos që duhet t'u jepen klientit	Shembuj:	
Tarifa të njëhershme në lidhje me ofrimin e një shërbimi investimi	Të gjitha kostot dhe tarifat që u paguhen shoqërive komisionere në fillim ose në fund të shërbimit(eve) të investimit të ofruar.	Tarifat e depozitave, tarifat e përfundimit dhe kostot e kalimit
Tarifa të vazhdueshme në lidhje me ofrimin e një shërbimi investimi	Të gjitha kostot dhe tarifat e vazhdueshme që u paguhen shoqërive komisionere për shërbimet e ofruara klientit.	Tarifat e administrimit, tarifat e këshillimit, tarifat e ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare
Të gjitha kostot që lidhen me transaksionet e iniciuara gjatë ofrimit të një shërbimi investimi	Të gjitha kostot dhe tarifat që lidhen me transaksionet e kryera nga shoqëria komisionere ose palë të tjera	Komisionet e brokerimit , tarifat hyrëse dhe dalëse që i paguhen administratorit të fondit, tarifat e platformës, shënjimet (<i>mark-ups</i>) (të përfshira në çmimin e transaksionit), taksa mbi transaksionet e kryera dhe kostot e këmbimit valutor.
Çdo tarifë që lidhet me shërbime ndihmëse	Çdo kosto dhe tarifë që lidhet me shërbime ndihmëse që nuk përfshihen në kostot e përmendura më sipër.	Kostot e ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare
Kostot e rastësishme		Tarifat e performancës

Tabela 2 — Të gjitha kostot dhe tarifat që lidhen me instrumentin financiar

Zërat e kostos që duhet t'u jepen klientit	Shembuj:	
Tarifa të njëhershme	Të gjitha kostot dhe tarifat (të përfshira në çmim ose si shtesë mbi çmimin e instrumentit financiar) që u paguhen furnitorëve të produktit në fillim ose në fund të investimit në instrumentin financiar.	Tarifa e administrimit <i>front-loaded</i> , tarifa e strukturimit tarifa e shpërndarjes.
Tarifa të vazhdueshme	Të gjitha kostot dhe tarifat e vazhdueshme që lidhen me	Tarifat e administrimit, kostot e shërbimit, tarifat e

	menaxhimin e produktit financiar që zbriten nga vlera e instrumentit financiar gjatë investimit në instrumentin financiar.	swap-it, kostot e huadhënies së titujve dhe taksat, kostot e financimit.
Të gjitha kostot që lidhen me transaksionet	Të gjitha kostot dhe tarifat që shkaktohen si rezultat i blerjes dhe shitjes së investimeve.	Komisionet e brokerimit, tarifat hyrëse dhe dalëse që paguhen nga fondi, shënjimet (<i>mark-ups</i>) të përfshira në çmimin e transaksionit, taksa mbi transaksionet dhe kostot e këmbimit valutor.
Kosto të rastësishme		Tarifat e performancës

SHTOJCA III

SEKSIONI 1 – Mbajtja e të dhënave të urdhrave të klientit dhe vendimi për marrëveshje

1. Identifikimi i Klientit;
2. Identifikimi i çdo personi që vepron në emër të klientit;
 - 2.1 Identifikimi i personit përgjegjës brenda shoqërisë komisionere për vendimin e investimit;
3. Identifikimi i instrumentit financiar;
4. Çmimi për njësi dhe karakteristikat e çmimit;
5. Çmimi;
6. Shumëzuesi i çmimit;
7. Monedha 1;
8. Monedha 2;
9. Sasia fillestare dhe karakteristikat sasiore;
10. Periudha e vlefshmërisë;
11. Lloji i urdhrit;
12. Çdo detaj tjetër, kushtet dhe udhëzime të veçanta nga klienti;

SEKSIONI 2 – Mbajtja e të dhënave të transaksioneve dhe përpunimi i urdhrave

- 2.1.1. Identifikimi i Klientit;
- 2.1.2. Identifikimi i çdo personi që vepron në emër të klientit;
- 2.1.3. Identifikimi i personit përgjegjës brenda shoqërisë komisionere për vendimin e investimit;
- 2.1.4. Numri i referencës së transaksionit;
- 2.1.5. Një përcaktim për të identifikuar urdhrin (ID e urdhrit);

- 2.1.6. Kodi i identifikimit të urdhrit të caktuar nga vendi i tregtimit pas marrjes së urdhrit;
- 2.1.7. Një identifikim unik për çdo grup urdhrash të mbledhur të klientëve (të cilat do të vendosen më pas si një bllok urdhrash në një vend tregtimi të caktuar). Ky identifikim duhet të specifikojë “aggregated_X” (X të mbledhura) ku “X” përfaqëson numrin e klientëve, urdhrat e të cilëve janë grumbulluar.
- 2.1.8. Kodi “MIC” i identifikimit të segmentit të vendit të tregtimit ku është paraqitur urdhri;
- 2.1.9. Identifikimi i personit të cilit i është transmetuar urdhri;
- 2.1.10. Identifikimi i Shitësit dhe Blerësit;
3. Kapaciteti tregtar;
4. Identifikimi i personit përgjegjës (Trader ID) për ekzekutimin;
5. Identifikimi i instrumentit financiar;
6. Aktivi bazë;
7. Në rastin e opsioneve, nëse bëhet fjalë për “Put” apo “Call”;
8. (Strike Price), është një çmimi i caktuar në kontratë derivative për blerjen apo shitjen e instrumentit;
9. Pagesa paraprake;
10. Mënyra e dorëzimit të instrumentit;
11. Lloji Opsionit;
12. Data e maturimit;
13. Çmimi për njësi dhe karakteristikat e çmimit;
14. Çmimi;
15. Shumëzuesi i çmimit;
16. Monedha 1;
17. Monedha 2;
18. Sasia e mbetur;
19. Sasia e modifikuar;

20. Sasia e ekzekutuar;
21. Data dhe ora e saktë e çdo mesazhi që transmetohet dhe merret nga vendi i tregimit në lidhje me çdo ngjarje që ndikon në një urdhër;
22. Data dhe ora e saktë e çdo mesazhi që transmetohet dhe merret nga një tjetër shoqëri komisionere në lidhje me çdo ngjarje që ndikon në një urdhër;
23. Çdo mesazh që transmetohet dhe merret nga vendi i tregimit në lidhje me urdhrat e dhëna nga shoqëria komisionere;
24. Çdo detaj dhe kusht tjetër që është dorëzuar dhe marrë nga një shoqëri tjetër komisionere në lidhje me urdhrin;
25. Radha e secilit urdhër të dhënë me qëllim që të reflektojë kronologjinë e çdo ngjarjeje që prek atë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në modifikime, anulime dhe ekzekutim;
26. Treguesi për shitjet e shkurtra (*Short selling*), zbatohet për raportet që tregojnë transaksionet me klientët individualë dhe jo për raportin e përmbledhur të transaksioneve të tregut;
27. “Waiver Flag”.

SHTOJCA IV

PËR RAPORTIMIN E TRANSAKSIONEVE NË TITUJT E QEVERISË

Neni 1

Transaksionet me titujt e Qeverisë Shqiptare jashtë një tregu të rregulluar/PSHT/POT

Tregtimi i titujve të Qeverisë Shqiptare jashtë një tregu të rregulluar/PSHT/POT nënkupton tregtimin në sportelet fizike apo virtuale të shoqërive komisionere dhe bankave të licencuara për të ofruar shërbime investimi në titujt e Qeverisë, me investitorët, të cilët mund të jenë klientë “joprofesionistë” (Individë/persona juridikë), klientë profesionistë/palë e pranueshme/klient i kualifikuar

Neni 2

Llojet e transaksioneve jashtë një tregu të rregulluar/PSHT/POT

1. Transaksionet që mund të kryhen jashtë një tregu të rregulluar nga shoqëria komisionere dhe banka e licencuar për të ofruar shërbime investimi janë:
 - (a) Marrje dhe Transmetim urdhri në tregun primar (ankand) për llogari të investitorit për blerjen e titujve të Qeverisë;
 - (b) Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Shitja e titujve të Qeverisë investitorit nga portofoli i bankës, apo shoqërisë komisionere);
 - (c) Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Blerja e titujve të Qeverisë nga banka apo shoqëria komisionere para datës së maturimit nga investitori);
 - (d) Ekzekutimi i urdhrat të klientit për titujt e Qeverisë (parimi i ekzekutimit më të mirë).
2. Përveç sa parashikuar në paragrafin (1) të këtij neni, shoqëria komisionere/banka raporton të dhëna për titujt e Qeverisë të vendosura si kolateral dhe shlyerjen e vlerës nominale të titujve të Qeverisë në datën e maturimit.

Neni 3

Dokumentacioni vërtetues

Banka apo shoqëria komisionere, në rastin e bonos së thesarit, pajis blerësin:

- (a) me një vërtetim për shpallje fitues për veprimet e tregut primar,
- (b) me një vërtetim blerje për veprimet e shitjes nga portofoli i vet.

Vërtetimi duhet të përmbajë të paktën emrin dhe adresën e investitorit, datën e transaksionit dhe datën e kryerjes së veprimit, vlerën nominale të bonos të blerë, yield-in, çmimin e skontuar dhe mënyrën e pagesës në maturim.

Banka apo shoqëria komisionere në rastin e obligacionit të thesarit, pajis blerësin:

- (a) me një vërtetim për shpallje fitues për veprimet e tregut primar,
- (b) me një vërtetim blerje për veprimet e shitjes nga portofoli i vet.

Vërtetimi për obligacionet duhet të përmbajë të paktën emrin dhe adresën e investitorit,

datën e transaksionit dhe datën e kryerjes së veprimit, vlerën nominale të obligacionit, çmimin e shitjes, vlerën e kuponit të ofruar, yield uniform i pranuar, shpeshtësinë e pagesës së kuponit, datën e pagimit të kuponit dhe mënyrën e pagesës në maturim.

Neni 4 **Mënyra e publikimit të titujve të Qeverisë**

Platforma e Raportimit të Titujve të Qeverisë

- (a) Platforma e raportimit është një sistem elektronik i raportimit dhe publikimit të të dhënave mbi transaksionet e ekzekutuara të titujve të Qeverisë jashtë një tregu të rregulluar/PSHT/POT;
- (b) Të dhënat në lidhje me tregun primar përfshijnë: çmimin dhe datën e emetimit, datën e maturimit dhe kuponin (për obligacionet) në ditën e emetimit. Këto të dhëna rezultojnë nga ankandet e tregut primar të titujve të Qeverisë të organizuara nga Banka e Shqipërisë.

Llojet e transaksioneve

Në platformën e raportimit llojet e transaksioneve do kenë një kodifikim si vijon:

A - Marrje dhe Transmetim urdhri në tregun primar (ankand) për llogari të investitorit për blerjen e titujve të Qeverisë;

A1 – Klientë joprofesionistë

(Individë);

A2 – Klientë joprofesionistë

(persona juridikë)

A3– Klientë profesionistë/palë

e pranueshme/klient i

kualifikuar.

B- Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Shitja e titujve të Qeverisë investitorit nga portofoli i bankës, apo shoqërisë komisionere);

B1 – Klientë joprofesionistë (individ)

B2 – Klientë joprofesionistë

(persona juridikë)

B3– Klientë profesionistë/palë

e pranueshme/klient i

kualifikuar

C - Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Blerja e titujve të Qeverisë nga banka apo shoqëria komisionere para datës së maturimit nga investitori);

C1 – Klientë joprofesionistë

(Individë);

C2 – Klientë joprofesionistë
(persona juridikë)
C3– Klientë profesionistë/palë
e pranueshme/klient i
kualifikuar.

D - Vendosja si kolateral
D1 – Klientë joprofesionistë
(individë);
D2 - Klientë joprofesionist
(persona juridikë)
D3- Klientë profesionistë/palë
e pranueshme/klient i
kualifikuar.

E - Shlyerja e vlerës nominale në datën e
maturimit
E1 – Klientë joprofesionistë (individ);
E2 - Klientë joprofesionistë (persona juridikë)
E3 – Klientë profesionistë/palë
e pranueshme/klient i
kualifikuar

F - Ekzekutimi i urdhrit të klientit për titujt e Qeverisë sipas parimit të
ekzekutimit më të mirë
F1 – Klientë joprofesionistë (individë);
F2 - Klientë joprofesionistë (persona juridikë)
F3 – Klientë profesionistë/palë
e pranueshme/klient i
kualifikuar

Koha e publikimit

Bankat apo shoqëritë komisionere publikojnë në kohë gati reale të dhënat sipas formatit të platformës që gjendet në faqen zyrtare të Autoritetit.